

INTERVISTË ME KAQUSHA JASHARIN

Prishtinë | Data: 2 qershor 2021

Kohëzgjatja: 161 minuta

Të pranishëm:

1. Kaqusha Jashari (E intervistuar)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Anita Susuri (Intervistuesja)
4. Besarta Breznica (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Jashari, nëse mundeni me dhonë një prezantim për veten? Vitin e lindjes, edhe me na tregu diçka për prejardhjen e juaj, familjen?

Kaqusha Jashari: Faleminderit shumë! Unë jam... kom lind me 16 gusht '46-tës, domethonë meniherë mas Luftës së Dytë Botërore. Kom lind këtu në Prishtinë, rasisht se nona jeme ka qenë musafire te prindërit. A përndryshë, na në atë kohë kemi jetu në Skenderaj, se baba me detyrë ka qenë atje, ka punu në pushtet. Edhe e kemi pasë ni shtëpi, mu s'po më kujtohet fare se shumë shpejt kemi shku prej Skenderajit.

Por me më regjistru nuk më kanë regjistru këtu në Prishtinë ku kom lindë, po më kanë regjistru atje në Skenderaj. Edhe gjithmonë (buzëqeshë) kom pasë nevojë për çertifikatën e lindjes me marrë atje në komunë. Edhe menoishin që unë jom e asaj zone, e Skenderajit, Drenicës. Po faktikisht prindërit e mi nuk kanë pasë lidhje me Drenicën. Pos që ka pasë baba obligim të kryen detyrën të cilën ja kanë dhonë.

Përndryshe, babën e kom nga regjioni i Anamoravës, osht' nga një fshat afër Kamenicës, tashti Dardanës, osht' Tugjec. Të gjithë të familjës janë Krasniqë, ai edhe mixha e kanë rujt mbiemrin Fejzullahu që e kanë trashëgu prej një gjyshit të mahershëm. Edhe shumica familjes jonë Krasniqët, a na Fejzullahu. E unë, domethonë mbiemrin e vajzërisë e kom Fejzullahu. Edhe baba edhe nona jonë martu '45-tën, jonë njoftu si partizanë. Se të dytë kanë qenë në luftë antifashiste, me ni brigadë.

Aty jonë njoftu, edhe jonë martu. Nona me kombësi osht', ka qenë malazeze, baba shiptar. Edhe pak osht' interesant pse une e kom emrin Kaqusha, se më pytshin edhe unë masandena i thashë nonës, "Tregom qysh ju erdh ideja, Kaqusha?" "Eh" tha, "kështu. Na masi kemi qenë në luftë, atëhere arma e parë e cila ka qenë e zbulume osht' arma raketore Kaqusha edhe kemi mendu...". Atëhere s'kanë mujt me ditë mashkull a femër, sikur tashti që zbulohet shumë herët, atëhere s'osht' ditë. Edhe nona tha,

“Mirë, në qoftë se lindë Kaqusha, femër, na po pajtohemi Kaqusha. E në qoftë se lindë mashkull?” E baba tha, “E valla në qoftë se lindë mashkull atëherë po ja qesmi emrin Partizan”.

Edhe nona jeme tha, “Kuku” tha, “kom lutë Zotin mos me lindë mashkull se s’po më pëlqen emri Partizan”. Vetëm ta dini që emrin Partizan pas luftës e kanë pasë disa individë, s’e di a keni ni për ni person në... ka qenë i njoftun s’e di në cilën lami në Prizren. Ka qenë Partizan... mbiemrin e kom harru. Domethonë, kanë dhonë emra në bazë të historisë edhe ngjarjes që... për shembull, une nuk jom prej atyne që e kisha bo. Se fëmijtë e mi nuk i kanë emrat, me shokun kur kom bisedu për emra diçka me lidhë me historinë.

Historia osht’ sot, nesra osht’ ndryshe, qashtu që nashta osht’ ma mirë me shënu diçka tjetër në familje sesa momentin historik. E unë e kom emrin për shkak të momentit që ka qenë shumë aktual atëhere kur u zbulu qajo raketa Kaqusha. Po çka o shumë interesant unë kom shumë shoqni se e kom Facebook-un tem, vajzat Kaqusha që prindët të cilët më kanë përkrah mue në atë kohë kur kanë lindë vajzat ja kanë lonë emrin Kaqusha.

Qashtu që une në shoqni i kom, ni herë e kom majt edhe ni takim me vajzat me emër Kaqusha edhe m’u kanë lajmëru 17. Edhe kemi hongër ni drekë të mirë. Do s’kanë besu, prindët që kom thirrë une edhe kanë kërku prej atyne, “Kur takoheni, na bon fotografi ta shohim a osht’ përnime” (qeshë). Qashtu që i kom do vajza të cilat jonë qashtu 30 vjeçare, tashti që jonë bo edhe nona e me emrin tem.

Anita Susuri: Ju na tregut një histori familjare...

Kaqusha Jashari: Edhe, edhe që e përmenda për babën edhe për nonën...

Anita Susuri: Po?

Kaqusha Jashari: Baba thashë osht’ prej një fshatit te Kamenica, po shumë herët jonë shpërngulë prej atij fshatit, me ‘32-tën po më dokët që ka qenë, para luftës kur ka qenë ai fëmi. Jo vetëm familja e tij, por po më duket në fshat shumë Krasniqët jonë marrë vesh me lëshu fshatin se ka qenë jeta e fshtirë. Ata kanë pasë pasuri në mal, por jo edhe tokën se osht’ vendi kodrinor. Edhe jonë marrë vesh me dalë prej atyhit edhe me shku me lyp vend ma të mirë. Ka qenë aktuale shpërngulja në Turqi edhe ata kanë shku prej Tugjecit në Shkup, prej Shkupit... do edhe kanë metë në Shkup, të familjës.

Do që kanë vendos kanë vazhdu edhe kanë shku në Turqi. Në Turqi baba qysh më ka thonë kanë nejt dy mujë. I kanë caktu ni vend diku me shku, s’ju ka pëlqy vendi fare edhe kanë thonë që nuk dojnë me shku atje. Edhe turqit, pushteti turk atëherë i ka ngarku në anije edhe i kanë çu në Shqipri. Në Shqipëri ka qenë pushteti i Zogut edhe baba atëherë më tha që, “Na dhanë ni vend, ni shtëpi edhe ni vend për me punu tokën”. Ka qenë mes Fierit dhe Semanit, Semani osht’ një fshat ma i madh në detin e, në Shipri.

Edhe Oxharë fshati, edhe aty ka qenë vendi shumë i fshtirë, kënetë. Kështu që, baba tha që baba i vet ka vazhdu me punu se e ka pasë zanatin e kovaçit, m'i bo ato aletet e punës, ka fillu po nuk i ka shku as puna atje. Edhe ky, baba tha, "Edhe i vogël une jom dashtë me lëvizë pak, me gjetë naj punë" edhe shpesh prej Fierit ka shku në Durrës. Edhe ka punu atje punë të rona të portës, me bajt sene. Ka qenë tregtia e zhvillume edhe me italianë edhe ma vonë kom zbulu se (qeshë) thojke, "E di italishten". Po une s'kom besu që qaq e din, po bash ka ditë me folë italisht, tu punu në port.

Shkollën fillore e ka regjistru në Fier atëhere, e në Fier ka qenë larg me ecë në komë nja shtatë kilometra prej fshatit në shkollë, shtatë kilometra me u kthy. Ka qenë në moshë pak ma i vjetër se çka osht' në rregull në shkollë fillore me u regjistru, por e ka kry shkollën fillore atje. Kur ka lëvizë, kur ka fillu lëvizja nacional-çlirimtare ai osht' bashkangjitë kësaj lëvizje edhe ka hi në ato radhët e partizanëve. Atëherë kanë qenë po më doket ato radhët e përzime të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë. Ashtu që nuk e di detajet e angazhimit tij, veç e di që ka qenë pjesëmarrës.

Di që është taku me Fadil Hoxhën, di që me to e ka formu radhën në Ramljan afër Gilanit {tregon me gisht mbrapa}. Edhe baba ka vazhdu me qat pjesën që e kanë formu Fadil Hoxha ka shku tjetërkah. E di që ka qenë shumë aktiv. Kaniherë ka punu edhe si përkthys kur u dufke me punu, se ka qenë këtu edhe italianë ka pasë, ushtarë italianë. Ka punu si përkthys. Ka qenë edhe në burg në Prishtinë, e kanë burgos si ilegal, e kanë burgos. Detaje tjera nuk i di, vetëm e di që edhe si i burgosur u dufke me qenë si përkthys, ajo e ka shpëtu pak, trajtimin ndaj, ndaj tij.

Pas luftës ka pasë angazhime të lloj-llojshme nga pushteti që thashë në Skenderaj ka punu ni kohë, mu s'po më kujtohet fare qajo jeta atje, dy vjet a sa, nona më tregojke që kanë pasë ni shtëpi, kanë pasë ni bunar në korridor (qesh) në shpi. Shumë osht' frigu kur dilsha une se osht' bunari aty. Niherë tha, "Të lypsha s'je kërkun, kuku, kqyrsha në bunar. Kur ty të kom gjetë" tha, "në bashqe midis patlixhonave, t'u marrë edhe t'u hongër. U tutsha edhe mos po del në rrugë". Por, në atë kohë rruga nuk ka qenë... {zgjatet për ta ndalur telefonin} nuk ka qenë rruga e ngarkume. S'ka pasë automjete, po kudo friga ka ekzist.

Ashtu që, i kujtohet ajo koha, nuk kanë pasë, qysh me thonë do kujtime të këqija prej jetës që e kanë pasë në Skenderaj. Se ka qenë koha pak e fshtirë në atë kohë në Drenicë për shkak ktyneve të radhëve jo vetëm partizane po edhe ato tjera që i thirrshin jo ballistë, jo... ashtu që baba ka pasë shumë kështu angazhim delikat, po nona thojke kur vishin njerëz prej malit pytshin, "Kush osht' në punë? A osht' Halili, a osht' tjetërkush? Në qoftë se osht' Halili po shkojmë, po dorëzohemi edhe nuk ka problem. A në qoftë se osht' tjetërkush jo". Kështu që, ka pasë njëfarë besimi ndaj tij.

Edhe ma vonë kur kom shku une në do aktivitete në Skenderaj, do njerëz të vjetër më thojshin, "Ti je çika e Halilit a? Ah, sa mirë, shumë mirë!" Domethonë, ni përkrahje e kom pasë kështu në atë kuptim të

besimit që mu kudo në politike më vyn (buzëqeshë). Në politikë gjithmonë më ka vy. Edhe prej atjehit, ni kohë shumë të shkurtë babën e kanë çu në Ferizaj, mu s'po më kujtohet fare, e në Gilan po.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjeç ke qenë në Gilan?

Kaqusha Jashari: Në Gilan... para Gilanit shkollën e kom fillu në Pejë. Se e kanë çu prej Gilanit, jo prej Gilanit, prej Ferizajit më doket direkt ka shku në Pejë, atje kom regjistru klasën e parë. Ai ka qenë komandant policie, baba. Masandej prej atjehit e kanë çu në Gilan edhe në Kamenicë. Edhe në Gilan edhe në Kamenicë kanë qenë kryetar të Komunave ose të Kamenicës ose të Gilanit edhe kom vazhdu shkollimin. Shumë osht' interesant se shpesh kanë ndrru vendet.

Qe po ju tregoj, klasën e parë e kom kry në Pejë {ngrit gishtin e madh}, klasën e dytë edhe tretë {numëron në gishta} e kom kry në Kamenicë, klasën e katër edhe të pestë në Gilan, klasën e gjashtë e kom kry këtu në Prishtinë, klasën e shtatë edhe tetë në Gilan. E në Prishtinë masanej e kom regjistru shkollën e mesme teknike, katër vjet edhe prej këtu hit masandej në studime kom shku në Beograd.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ju ka dokë qyteti në atë periudhë? A u konë i pazhvillum, çfarë qyteti ishte?

Kaqusha Jashari: Po kqyr, a dini çka, si fëmi gjithmonë e kemi kqyr shoqinë e cila osht', vetëm çka mu po më kujtohet, se jom une dhe dy vllazën kemi qenë, domethonë këta të mitë i kanë pasë tre fëmi. Mu të parën edhe dy djem. Na gjithmonë kemi shiqu çfarë shoqnie kemi, gjithmonë kur kemi pasë me dalë prej Gilanit me shku dikun na kemi qajt. Se e kemi pasë atje një ambient shumë të bukur, kemi pasë vend ku kemi mujt me zhvillu aktivitete me lujt e me, me u marrë me sport. Aty ka qenë parku i naltë, u thirrke. Në Gilan kur u tubojshmi fëmitë, jo vetëm të mahallës po edhe shkollës edhe lujshmi.

Çka më kujtohet në atë kohë, e di që juve ju intereson edhe mënyra e edukimit se te familjet e përzime pak osht' ma ndryshe se te tjerë, se na në shpi kemi pasë edhe nga ana e babës fejës muslimane a nga ana nanës fejës ortodokse. Qashtu që shumë ka pasë ni ndikim pozitiv në tërësi veprimi i nonës teme. Mu po më kujtohet që e pytshin nonën, këta që jonë nga ana e babës, "A bon këto me hongër?" Domethonë, a osht' ushqimi pa mish derri, ose... "A bon këto?" "E pse" thashë, "po e pytni gjithmonë nonën e jo babën", "Po" tha, "Danica, nuk na mashtron, ja te ajo osht' e sigurtë".

Po nona e ka respektu fejën edhe të kundërtën. Gjyshja jeme e cila ka jetu herë te na, herë te mixha, gjyshja jeme, interesant osht' ajo ka qenë fetare e ka pasë ni dhomë, vendin e saj, ku e ka pasë atë postacion [mbulesë] me u falë edhe osht' falë pesë here në ditë. Edhe e ka pasë rendin e vet, me i la komët e durte, shamijën me lidhë {bën sikur lidhë shami}, sikur sot p'e shoh. Ka qenë ni gru shumë... e vogël, shumë e dashun, shumë.

Edhe kur ka qenë koha e ramazanit, nona jeme kurrë s'ja ka prishë rendin asaj, për iftar, për syfyr, kurrë. Edhe ato përmenke kjo gjyshja, përmenke. Thojke, "Me Danicën nuk ka". Edhe osht' interesant

ajo ja ka përmën asaj që ka qef me pasë sahatin e dorës {prekë dorën}, edhe ja ka përmën babës me ble, “Danicës me ja ble sahatin. Jo sot, jo nesër” tha, “met pa ble”. Edhe para vdekjes e ka lonë amanet tha, “Danicës me ble Halili sahatin”. Edhe baba meniherë, nesër ditën meniherë e ka bo ato.

E qashtu që nona ka pasë ndikim shumë në, në rendin e shtëpisë, me rregulla, për shembull na kemi ditë... ajo shtëpiake ka qenë, ajo hiç s’ka punu [jashtë shtëpisë], na kemi ditë kur është dreka gati. Në ora 14:00 dreka osht’, për ata që vijnë prej shkollës edhe për ata që do të shkojnë. Domethonë, drekën na e kemi pasë në shpi gjithmonë të rregullt. Masandej e ka pasë edhe mënyrën e pastrimit të shtëpisë na kemi ditë të shtundën osht’ pastrimi gjeneral. Edhe na kush aty zatetet atëhere ndihmon, a tepihat m’i shkund a, najsen me bajt a, gjithmonë shtunja dihet. Rendi ka qenë asisoji.

Edhe çka osht’ interesant ato kurrë s’kom harru, edhe kur i shoh fëmijtë t’u hongër bukë jashtë më bjen në mend nona, neve kurrë s’na ka lonë me hongër diçka në dorë jashtë. “Ja-a” tha, “kur jeni untë hajdeni këtu, uluni, hani edhe dilni”, na thamë, “Po dalin edhe tjerët”, “Tjerët s’po më ineresojnë. Une nuk du me menu a osht’ dikush untë, a ka, a s’ka, a ju me hongër para atynve” tha, “s’vjen në konsiderim. Bukë në shpi edhe masandej dilni”. Kurrë s’na ka lonë me hongër bukën jashtë. A kemi qenë prej shkollës untë si çdo fëmijë, “Ama pak bukë” {zgjat dorën} me marrë edhe me shku me lujt. “Jo, jo, jo, ma së pari në shpi masandej shkoni”.

Ajo osht’ diçka që më osht’... për neve ka qenë ajo që gjithmonë më pasë kujdes a kanë tjerët. Se na e kemi pasë ni jetë të mirë si fëmijë, se baba ka punu, rroga ka ekzistuar. Çdo mujë me të parin nona ka qenë ajo, qysh thojnë tash që menaxhon, menaxhon me këtë, pare. I jipke nonës, nona me të parin paret në dorë, se gjithmonë me të parin ka qenë rroga. Me të dytin shkojshmi në dyqan e marrshmi për ni mujë çka na vyn, jo vaj, jo sheqer, jo krejt. Edhe atëhere na bike ka ni çokolladë. Nuk ka mujt me pasë kështu sikur sot çdo moment, disa herë në ditë, jo, ka ni çokolladë në mujë.

Ajo osht’ një, e dyta, kur kemi qenë pak ma të rritur, në Gilan sidomos, atëhere në shkollë fillore kem te tretë, neve nona na jepke pare në dorë, “Merrni e këto e keni për këtë mujë. Me shku në kinema, me shku sport me kqyr, ku ju vyn edhe tjera pare nuk ka”. E kanë nda për neve. E ajo më ka taku mu, se unë e para, ma e madhja edhe une kqyrsha cilin film me kqyr, ku me shku. Futboll kemi shku, gjithmonë Gilani e ka pasë ekipën e mirë, e kemi shiqu futboll, e kemi kqyr edhe hendboll. Po edhe në atë kohë edhe shumë ma vonë femrat kurrë s’kanë pagu. Femrat kanë pasë lejen pa bileta me hi me kqyr lojën, ajo ka qenë s’e di ni vendim, a ni traditë a, çka nuk e di, vetëm e di që unë si femër kurrë s’kom pagu, po pagujsha për, për vllazën.

Këto kemi pasë, kesi mënyra si fëmijë edhe në pushim, jo vetëm kështu në shpi. Di që kemi shku nja dy herë në Bullgari me kerr, atëherë e kemi pasë kerrin. Edhe na jepshin prindërit kur mrrijshmi, qekaq jonë paret për ushqim për këto ditë sa jemi aty, për shembull, “Për dhetë ditë këto pare jonë për ushqim, hani kur doni edhe çka doni”. Edhe na i dajshmi paret mes veti edhe nona s’ka mendu për neve, për bukë. Në fund të fundit ajo ka qenë mirë edhe për këta edhe për neve se na patëm pare

fëmitë me pasë pare osht' sen i madh (qeshë). Asaj ma lehtë, se nuk ka mendu për ushqim qashtu që në shumë çka ka ndiku ajo.

Masi kom fillu me folë për këto se ka qenë gru bujare, po ju përmen edhe diçka tjetër që neve na ka orientu ajo në krahasim edhe me familje tjera të cilat kanë qenë të përzime. Se na jena shoqnu kështu, u takojshmi me familjen e Sinan Hasanit, familjen e Ali Shukriut, kur kanë pasë do takime, do vizita shkojshmi edhe familje, po më kujtohet edhe ni rast i cili ka qenë shumë i randësishëm për neve si fëmijë, me ditë kush jemi, se nona malazeze, baba shiptar, gjuha, ma shumë kemi ditë serbo-kroate se sa shqip. Gjyshja kur vike në shpi mirë me to, po kur s'osht' gjyshja atëherë me nonën, baba kurrë në shpi, ai gjithmonë në punë qashtu që shumë pak kontakt me babën.

Edhe me '61-tën po më kujtohet ka qenë koha e regjistrimit të popullatës, na kemi banu këtu në Prishtinë {tregon mbrapa me gisht} mbi hotel Zvicër, "Diamond", aty e kemi pas banesën. E kanë ardhë nja tre vetë me bo regjistrimin e popullatës. Me siguri nona e ka ditë kur vijnë. Ata hinën mrena i mushën ato, shënimet i bonën për babën, për nonën edhe për fëminë, na kem aty. Emnat, mbiemnat krejt edhe te rubrika kombësia, gjuha, të gjitha ato shënimet, nxanës a, student a. Edhe ke kombësia {shikon anash} na nisëm m'u kqyrë mes veti, edhe nona më thirri mue, shkova aty te dhoma. Tha, "Kqyre ç'a po të thom" tha, "qetashti po të thom edhe mo mos m'pyt kurrë. Çka osht' baba, ju jeni edhe aty diskutim nuk ka".

Edhe jom kthy, thashë, "Shiptar", edhe u regjistru shiptar. Këta dy vllazën qysh thom une, qashtu edhe ata u regjistrun krejt. Kur erdh rubrika gjuha, na shqip pak dishmi, me nonën t'u fol serbo-kroatisht ujë. Edhe në shkollë qashtu jemi regjistru, se në Pejë e regjistrova serbisht. Edhe unë thashë, "Gjuha amtare serbo-kroate". Edhe nona po kqyrë edhe nuk reagoi kurgjo, kur e kryjtën krejt, kur dulën tha, "Qysh vendosët gjuhën?" Po thashë, "A me rrejt a? S'muj me rrejt, nuk dijmë shqip sa gjuhën tonde edhe amtare domethonë e nonës. Gjuha jote osht' qajo". E i erdh pak mirë, e pashë a din se, kemi qenë diqysh, s'kemi deshtë me ofendu asnjenin edhe ajo ka ndiku mirë.

Por, kom vrejt masandenaj me fëmi ktyne që i përmenda, djemtë e Ali Shukriut e Sinan Hasanit, fëmitë këta, ata a e dini qysh jonë regjistru, jugosllav. S'e ka ekzistu musliman, po ka ekzistu edhe ni rubrikë jugosllav. Ajo komb nuk osht', po qe. Edhe qysh shiptar, qysh shiptar? Shpesh na kanë pyt, "Qysh ju shiptarë?" "Po, lehtë" kemi thonë, "qysh osht' baba edhe na jemi, qashtu ka thonë nona". Qashtu që nona, ani që ka qenë gru tjetër edhe nga feja edhe nga kombi krejtësisht ndryshe se baba, ajo ka ndiku pozitivisht në neve, te tretë, edhe në vllazën edhe, edhe te une.

Qashtu që edhe ma vonë shumë, kur kenë këto problemet me Kosovën, kur kesh une në funksion e më hekën prej funksionit ka ndodhë që me i organizu zgjedhjet na, zgjedhjet qysh thojmë të Rugovës në atë kohë edhe Sërbisë, unë e di që niherë tezja më ka ardhë këtu në shpi te nona, motra vet e tha, "Dano," tha, "çka po bojmë na me këto zgjedhje bre?" Tha, "Ti zgjedh çka dush, a sa për mu ku i kom fëmitë, ku e kom burrin aty jom". Edhe nona jeme ka votu bashkë me babën, domethonë në zgjedhjet

tona. Kur ka qenë edhe referendum atëherë kanë banu me ni shtëpi në fshat se prej kësaj banese këtu e kanë qit babën me '92-tën, e kanë largu prej këtuhit policia babën.

Erëmirë Krasniqi: Prej kësaj banese apo?

Kaqusha Jashari: Jo, ajo osht' banesë e jemja, a kjo {tregon me gisht poshtë} osht' banesa e babës tem edhe prej këtuhit e kanë qit. Këtu ka ardhë ni sërbe, menxi qe tash s'ka ni vjet që e kom rregullu statusin e banesës se ka qenë në procedurë. E kanë qit se e ka pasë ni qëndrim shumë përparimor baba, ka qenë kryetar i Lidhjes së Luftetarëve, atëherë kur kenë do thyrje. Ju jeni të reja s'ju kujtohet, vetëm ka ndodhë mas asaj kur ka hi Millosheviqi këtu.

Atje në Sërbi me i thy xhamat e ktyne furraxhive, njerëzve që kanë jetu edhe që kanë punu jashtë në Sërbi, sidomos në Vojvodinë kanë qenë shumë prej Prizrenit, furraxhi, krejt kanë majt atje. A nga Tetova kanë qenë këta ambëltoret kanë pasë, xhamat i kanë thy. Edhe baba u çu si kryetar i luftëtarëve ka kritiku, ka qenë shumë jehonë e madhe kur ka folë ai. Qashtu që i erdh rasti me e qit prej këtuhit, prej, prej banesës. Ka qenë ni sërbe e mu po më thotë, "A po bomi kojshike e mirë", "Po" thashë, "me ty kojshike e mirë që ma ke qit babën prej banesës". Edhe... mas luftës kanë shku vet, vet kanë shku.

Erëmirë Krasniqi: A të kthehem pak ma mbrapa...

Kaqusha Jashari: Hajde, tashti për shkollë fillore?

Erëmirë Krasniqi: Po, ku, ku në cilin qytet ma shumë e keni kry...

Kaqusha Jashari: Ma shumë, ma shumë në Gilan. Interesant osht', dy herë kemi shku në Gilan, edhe dy herë kemi ardhë në Prishtinë, po ma gjatë kemi nejt në Gilan se që kemi qenë në Prishtinë, pos kur kom shku në shkollë të mesme. Une, edhe vllaznit nisoj, kemi pasë në shpi nifarë atmosfere që duhesh me u marrë me diçka. Nuk duhet veç me shku në shkollë, po duhesh edhe diçka ma tepër, nifarë aktiviteti, qashtu që me sport jemi marrë të gjithë. Se baba ka qenë bjeshkatar, nuk ka lujt naj sport as futboll, as hendboll, as kurgjo. Po na e kemi pasë afër, se shkollat kanë organizu takime mrena shkollës, masandej shkolla me shkollën edhe diqysh jemi eksponu si sportist.

Edhe vllaznit edhe une, une në Gilan e kom fillu hendboll me lujt, këtu kur kemi ardhë në Prishtinë në shkollë të mesme, kom pasë profesor atë, dy profesorë Xhavit Spahiun, ai ka qenë një prej themeluesve të hendbollit në Kosovë edhe Hisen Rakovica. Masandej në Fakultet të Edukatës Fizike ka qenë për atletikë, po ai ka vërejt që unë kom talent për lojnat edhe më ka thonë që osht' mirë me u lajmëru në klubin "Kosova" të hendbollit edhe jom anëtarësu. Pas meje edhe ni çikës prej shkollës medicinës, të gjitha kanë qenë vajzat e shkollës së fiskullturës.

Se atëhere kanë ekzistuar shkollat të mesme profesionale, shumë, shumë të organizime. Une po ju thom shkolla teknike ku kom qenë une gjenerata e parë, ka qenë në shkollë që ka prodhu shumë kuadra profesional, shumë. Ata që s'kanë vazhdu fakultetin kanë qenë teknik nëpunës dhe kanë qenë njerëz shumë të aftë, qashtu edhe shkolla e fiskullturës ka pasë shumë njerëz që kanë arritë në sport. Edhe bashkëshorti jem që e kom njoftu atëhere t'u lujt hendboll edhe ai ka qenë hendbolist.

Ka arritë shumë, ka doktoru edhe shokët e tij, asaj gjenerate në fakultet kanë qenë masanej profesorë si Beqir Hasanxhekaj, mos t'i përmeni tashti edhe ky Isen Rakovica edhe do profesorë tjerë. Qashtu që, une kom qenë edhe në vajzë prej shkollës medicinës, po kemi qenë të mira s'jemi dallu fare prej tyre që e kanë profesion sport. Edhe kom lujt për pak me në turnir kur kemi qenë për në goll, dy gola s'kemi mujt me shku në ligën e parë të nivelit të Jugosllavisë, qaq ka qenë ekipë e Prishtinës e mirë. Mas shkollës fillo... të mesme këtu në Prishtinë une kom shku në Beograd në studime.

Erëmirë Krasniqi: A munësh me na tregu edhe për Prishtinën, domethonë kanë qenë të '60-tat?

Kaqusha Jashari: '61-ta që e kom regjistru. Prishtina atëhere ka qenë një, tashti s'e di për çka ma shumë me folë a për shkollën, për shkollën e mesme për shembull po ju tregoj, kemi...

Erëmirë Krasniqi: Po menoj urbanizimi, nashta çka ka pasë...

Kaqusha Jashari: Po, kemi pasë shkollë të mesme, shkolla e mesme ka qenë këtu në objekt ku osht' tash ky Arkivi i Prishtinës. Edhe në atë kohë aty kom fillu klasën e parë, e të dytën, po të tretën edhe të katërtën, kemi kalu në objektin e ri që osht' tash "Adem Gashi". Kjo shkolla që ka qenë bashkë me "Sami Frashërin" që janë nda. E tashti ata kanë vazhdu aty, aty e kom kry klasën e tretë, edhe të katërtën, kemi pasë fushat sportive edhe po ju thom që e kemi pasë në organizatë rinore shumë të fuqishme.

Nuk e di, ndoshta unë që nuk jom konë bash, jo e urtë, e urtë shumë e disiplinume po jom marr me gjithçka edhe qashtu tu bo aktivitetin edhe tu bo do kësi aksione punuse, na kanë organizu me shku me i rregullu do stadione, do fusha sportive. Edhe mu më kanë zgjedh për kryetarën e rinisë. Edhe unë prej klasës parë deri në klasën e katërt në shkollë të mesme une kom qenë kryetare, katër vjet. S'e di a mundeni me besu që në atë kohë na kena pasë radio mrena shkollës. Edhe kemi pasë orkestrin tonë të shkollës.

Aty ka fillu, ani që osht' Fejzullahu Sabria, nuk e kom kurgjo kështu në familje, po ma vonë kur ka qenë ai pak ma në zo, pyetshin, "Çka e ki Kaqushën, a e ki motër?" Tha, "Une e pranoj si motër, ani që..." edhe mu më pyetshin, "Çka e ki Sabrinë?" Thashë, "E pranoj si vëlla, ani që s'e kom kurgjo". Po kushërinë i tij, ai ka ndërru jetë vitit të kalum, a para dy vite, Hilmi Statovci ai ka qenë me ato... {bën sikur luan me bateri}

Anita Susuri: Bateri?

Kaqusha Jashari: Bateria, po. Ka qenë jashtëzakonisht i mirë, kemi pasë dy gitarista edhe Sabri Fejzullahu, ai filloi me këndu me këtë orkestër shkolle, se dy herë në javë na kemi organizu atëherë e thirrshim *matine* ballo, dy herë në javë kemi pasë. Jo ditëve vikendit, po ka qenë po më doket e hane edhe e ejte në këtë shtëpinë që ka qenë e Armatës. Aty ka qenë ni sallë e tashti po më duket kinemaja osht’.

Anita Susuri: Po.

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Kemi pasë nifarë rregulli me hi të veshun {prekë bluzën e vet}, kemi thonë asni mashkull pa kravatë. E çka bojshin, kravata kush me pasë krejt në atë kohë, dy-tri kravata krejt kanë pasë. Hike dikush me kravatë e mpshtjellke e gjujke {përshkruan me duar} prej dritarës tjetërkush me hi, qashtu (qesh).

Ka qenë shkolla teknike shumë, shumë e organizume. Kemi punu në fushë, tashti osht’ ajo pjesa gati industriale prej Veternikut kur shkon, qajo rrafshinë, ka qenë luledilli të mledhun edhe misri. Na kemi punu për qat ndërmarrjen “Agro-Kosova” për pare. I kemi nukë ato shtalbat. Na kanë pagu edhe me ato pare kemi ble edhe instrumentet edhe radio-stacionin. A radio për çka na ka vyjt, në pushim të madh lëshojshim muzikën, ka qenë Elvis Prislli, atëherë shumë aktual e dëgjojshti, e lujshmi e... Masandej informatat e rëndësishme për shkollë, kush ka lujt, cila ekipë ka fitue.

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Kemi qenë shumë, shumë aktiv. E kur e kom kry klasën e katër të shkollës të mesme...

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Edhe ka qenë një bisedë se kom qenë shumë aktive, atëherë ka qenë kryetari i Rinisë të Kosovës, Mahmut Bakalli, rinisë, {ngrit gishtin tregues} jo partisë. Edhe ka qenë ni bisedë që jom shumë aktive edhe që osht’ mirë me bisedu, ajo me vazhdu me më zgjedh si kryetare e Rinisë të Prishtinës. Edhe mu më kanë thirrë, kom pasë bisedë. Une, dëshira jeme me vazhdu fakultetin, a këtu s’ka pasë ndërtimtari. Sa ka fillu Universiteti i Prishtinës me i kapë do fakultete, po ndërtimtaria, teknika, kërkun s’ka qenë atëhere.

Edhe une në shpi i thashë babës, “Ajt të bisedojmë çka me bo, kështu, kështu më kanë thonë, çka me bo”. Tha, “Ti munesh me bo çka dush, po ta dishë në jetë osht’ mirë me pasë ni zanat. Në qoftë se diçka

nuk të shkon në politikë, e ki zanatin”. Shkolla teknike për to ka qenë zanat, edhe prej shkollës teknike jetë teknik, munësh me punu, po mirë osht’ me vazhdu, masi une kom qenë e shkëlqyshme edhe në matematikë.

Une e kom deshtë shumë matematikën, a ndërtimtaria ka qenë diçka që osht’ si fakultet ma i fshtirë. Po jom marrë edhe me pikturim, se kom fillu në shkollë të mesme une me pikturu, kom pasë qef edhe artin. Arkitektura osht’ diçka edhe si profesion atraktiv, po të vyn edhe talenti. A une kom pasë për shkak të pikturimit e hapësirës, e kuptimit të hapësirës në arkitekturë edhe ku me shku, me shku në Beograd se këtu s’ka pasë.

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Kur keni qenë kryetare e rinisë...

Kaqusha Jashari: Po.

Erëmirë Krasniqi: Me na tregu pak edhe për aktivitetet kulturore në qytet?

Kaqusha Jashari: Në qytet na kemi pasë ku, atëhere... dikush menon që krejt ka fillu prej sodit, nuk osht e vërtetë. Në atë kohë ka ekzistuar Kino Rinia, ka qenë edhe salla cila osht’ edhe tashti, s’e di a osht’ ABC-ja aty, a ka kino, nuk e di. Vetëm ka qenë edhe bashcja, qashtu që...

Erëmirë Krasniqi: Bashcja ku ka qenë?

Kaqusha Jashari: Bashcja me ekran, ke mujt filma me kqyr veç në bashçe, veç në sallë. Rinia ka qenë e organizime atëhere, e thirrshmi Komiteti i Komunës i Rinisë, Komiteti u thirrshin atëhere. Edhe kemi pasë kryetar kanë ardhë te na në vizitë një s’ja di emrin, mbiemrin Hashani, ka qenë kryetari, ka qenë te na në shkollë disa herë. Na thirrshin kryetarët që kemi qenë nëpër shkollë për aktivitete organizojshin edhe akcione punuse. Që këtu bash ku osht’ kisha kontestuse ortodokse, aty kanë qenë fushat sportive që na kemi punu, rinia. Me kesi {lëviz dorën vertikalisht}, me...

Erëmirë Krasniqi: Shat?

Kaqusha Jashari: Po. Kemi rrafshu, kemi qit zallë e, kanë qenë fushat e sportit edhe basketbollit edhe hendbollit, ka qenë aktiviteti i rinisë. Këtu ku osht’ {tregon me dorë djathtas}, po më duket “Pastrimi” e ka marrë qat hapsirën, ka qenë në stadion i vogël i atëhershmi, po shihen tash po më duket këto ulëset, ende jonë. E përfuni kanë marrë si dyqane i kanë bo, po aty kemi pasë ato zhveshtore, në atë stadion aktiviteti ka qenë edhe prej shkollave, po ka qenë edhe qytetit. Aty une, për shembull kom ushtru hendboll se ekipa “Kosova” e hendbollit e ka pasë selinë aty.

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Sa për urbanizëm sa osht' ndërtu edhe në atë kohë, krejt këto ndërtesa, edhe kjo ndërtesë {tregon me dorë poshtë} në atë kohë është ndërtu, kjo rruga "Rexhep Luci" {shikon dhe tregon majtas} krejt këto ndërtesa janë ndërtu në atë kohë. Ka qenë Enti për Urbanizëm i cili ka vepru atëhere për urbanizmin e qytetit. Ka qenë atëhere ni arkitekt të cilin e vrajtën mas luftës Rexhep Luci, që e ka edhe rruga, se vet familja e vet ka banu këtu {tregon me dorë djathtas}, në këtë, mrapa, ndërtesë. Sivjet, a vitit të kalum vdiq edhe motra e tij, Ahsene Agaj Luci.

Nuk muj me thonë që krejt ka fillu prej kësaj demokracie, le të më falin këta të ri çka jonë, po ka qenë ni organizim edhe në atë kohë. Edhe në atë kohë nifarë rendi, tashti me siguri ka pasë shumë familje të varfuna. Na, familja jeme nuk ka qenë e varfun, po nuk ka pasë pasuni sikur do që kanë në kohë, ditën e sodit. Na e kemi pasë ni standard jetësor mjaft për jetën normale, banesat jonë nda në kuadër të ndërmarrjeve ku kanë punu njerëzit, institucioneve gjithmonë.

E tashti prioriteti qysh i kanë bo ajo osht' diçka tjetër, secila firmë i ka pasë prioritetet e veta. Ma së pari prioritet për kuadro, po masandej prioritet kanë pasë edhe ata me përvojë ma të gjatë në atë organizatë edhe do kushte tjera, qashtu që ni standard ka qenë normal. Nuk ka qenë problem për shembull për familjen teme me shku verës në deti pushim edhe dimrit me shku në skijim. Nuk ka qenë problem fare. Me qato pare që jonë marrë prej rrogës ti ke mujt edhe me marrë kredi, se kërkush s'ka mujt me ble edhe pajisje shumë të shtrejta të skijimit, për shembull me pare të gatshme, po me, me kredi.

Edhe si familje sportive na gjithmonë kemi pasë në kokë qat, po mendoj plan, që verës me shku në deti për me notu, a dimrit me shku në Brezovicë, sidomos në Brezovicë në skijim. Edhe qashtu kanë vazhdu edhe familjet e vajzave të mia, të gjithë dijnë. Nashta për shkak të asaj se baba i vet, shoku jem ka qenë sportist, ka qenë mësus edhe i notit edhe i skijimit, e nuk ka pasë kuptim tashti fëmijët e tij mos me ditë (qeshë), a ai me mësua studentë. Qashtu që, jeta jonë ka qenë ni jetë kështu normale une kisha thonë, për ni standard normal, ekstrem jo, as kërkesa s'kemi pasë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë situata me familje tjera, a kanë punu njerëzit veç për shtet a ka pasë...

Kaqusha Jashari: Jo, jo kanë ekzistuar edhe punë private, zanatlitë për shembull kanë pasë përparësi, se për shembull për me ble ni dyqan përparësi kanë pasë ata që kanë zanatin. Edhe shumë zanatli ka pasë, jo rrobaqepës, jo këpucëtarë, jo do veprime shërbyse tjera. Kanë ekzistuar qysh jo, ka qenë e lejume.

Erëmirë Krasniqi: A ju kujtohet pjesa e vjetër e qytetit?

Kaqusha Jashari: Pjesa e vjetër po më kujtohet, qysh jo, unë gjithmonë kom kalu aty për me shku në shkollë të mesme, ka qenë në rrugë shumë, nuk e di, une nuk jom prej atynve, nuk e di çka kisha mendu në atë kohë, po sot për shembull kurrë s'i kisha prishë ato objekte. Se duhet me i konzervu edhe me i rujt, ato janë atraktive jo vetëm për shkak turizmit po kështu si pjesë e zhvillimit të qytetit. Mu po më kujtohet ajo pjesa e vjetër që ka qenë një librari e madhe e sa herë hishmi mrena, ato dërrasa i lyjshin me... s'e di çka osht' ajo, të zeza edhe i vike era kur shkojshmi me ble libra, (qeshë) me ble.

Erëmirë Krasniqi: Po mendoni te dyqanet ku tash osht' përmendorja bashkim-vllaznimi apo diku tjetër?

Kaqusha Jashari: Jo, pak ishte ma naltë, atje ku tash osht' qeveria, para kuvendit, po kuvendi kur osht' ndërto. Mu po më kujtohet kur kemi kalu aty që kemi pa koridore mrena edhe fëmija hishin me pa çka ka, aty kanë qenë me siguri diçka, se masandej kanë zbulu në çeshme në qendër ku osht' hoteli. Aty ka ekzistuar diçka, prej ku me ditë çfarë objekti vjetër si tunel edhe u tutshmi me hi mrena mos po jemi se s'mujmë me dalë. Se kanë qenë tamam si tunel edhe...

Po s'e di pse s'kanë pasë kujdes në atë kohë për me rujt këto trashëgiminë. Po thojnë që çeshmja e cila osht' në oborr të kësaj, xhamisë aty në qendër që osht' uji prej Gërmisë, në kohën e turqve osht' bo, edhe ato gypat jonë prej keramikës, prej dheut {ngrit supet}. E masandej kanë zbulu, thojshin që edhe këtu kur kanë bo këtë plato te hotel "Diamond" që edhe aty kanë gjetë do...

Erëmirë Krasniqi: Po aty ka qenë xhamia e Llokaçit. E kanë rrëzu e kanë maru tani [hotelin Bozhur].

Kaqusha Jashari: Eh, po, po e kanë maru, po, po qashtu, po. Po a e dini çka, kur vendos politika qashtu osht', se politika e ka gjithmonë në kokë, çdo politikë që me tregu kohën e vet që ka bo do ndryshime e tashti krejt ajo çka osht' ma e vjetër s'bon e duhet me prishë. Po që merrni shembullin t'fundit të Shqipërisë, krejt me rrënu, kanë shku me i rrënu edhe shkollat çka osht' shkolla, objekt që nuk ka ni, qysh me thonë, lidhshmëri me ish sistemin. Shkolla osht' shkolla në çdo sistem, ajo osht' edukim, e kanë prishë, domethonë osht' prishë shumëçka. Çarshia e vjetër shumë ka qenë interesant edhe e mirë, mu po më kujtohet, une sa here kom shku në shkollë, kom kalu aty, ajo pjesa e vjetër.

(Qeshë) Më ra në mend diçka, nashta nuk osht' për me thonë për me inçizu, po e thomë. Në atë, në atë librarijën e madhe që ka qenë në fillim {përshekruan me duar} bash po më kujtohet te dera shumë e madhe ka qenë, aty mrena libra, fletore, tu marrë une libra s'e di, ka hi ni rome edhe po thotë atij shitësit, "A kini fletore për klasën e parë, të shkollës 'Meto Bajraktari'?" (qeshë).

Anita Susuri: Precize.

Kaqusha Jashari: Precize, ku e ka fëmiun në shkollën "Meto Bajraktari" (qeshë). Edhe, edhe une reagoja thashë, "Shkolla nuk osht' më rëndësi për fletore, fletoret janë nisoj për krejt", "Po nuk e di,

une vetëm po thom, ai osht’ aty edhe aty mësusja i ka thonë, fletore për shkollën ‘Meto Bajraktari’” (qeshë). Edhe aty ka qenë furnizimi i të gjithëve, nuk e di, kanë ekzistuar edhe libraritë tjera, po sa për mu edhe për familjen teme masi kemi banu afër për neve qajo librari osht’ ma, ka qenë e para.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë edhe zanatli aty, a qysh ka qenë?

Kaqusha Jashari: Ka pasë, ka pasë edhe zanatli, po tash s’po më kujtohet, po më doket dikush ka punu edhe kësi plisa {vendos dorën mbi kokë}, s’e di çka pat hala. Nuk e di, vetëm ka pasë zanatli, ka pasë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë kompozicioni etnik atëhere, a jeni përzi, a keni pasë shoqëri?

Kaqusha Jashari: Në shkollë, na kemi pasë në shkollë klasët veç, po me ni shkollë. Klasa gjuhë shqipe, klasa serbo-kroate, vetëm ta dini që nuk ka pasë mjaft kuadra as për serbo-kroate, as për shqip. Edhe ka ndodhë që ni profesor për ni lami me dhonë edhe sërbsisht edhe shqip, që po ju përmendi emrin ky për matematikë ka qenë ni profesor, ai ka dhonë edhe te na edhe në atë klasën tjetër, edhe sërbsisht edhe shqip, qysh e pat emrin... bash, bash shpesh po më bjen në mend ai, që momentalisht...

Erëmirë Krasniqi: Ju kujtohet mandej.

Kaqusha Jashari: Eh, po. Qashtu që, vetëm sa për nxanës po ju tregoj, na nuk kemi pasë mes veti problem. Une shqip shumë ma pak kom ditë atëherë, për shkak nonës, ju thashë edhe në klasë kom pasë një koleg prej Gjakovës, bash mbiemrin Stojanoviq e ka pasë, prej Gjakovës aty. Zar’ shkollë teknike s’ka pasë në Gjakovë e ku me ditë këtu është regjistru. Zhivko. Folke shqip me shiptarë si bylbyl, a une *tëp-tëp tëp-tëp* {onomatope} ka pak, ka pak, kuku çka më ardhke inati. Thashë ai sërbi me ditë gjuhën ma mirë se une, po kurrë s’ia lejoj vetes. Edhe s’e kom leju, edhe atëherë përnime une, une kom mësu.

Ma së shumti gjuhën e kom mësu kur kom punu në sindikat, edhe po ju tregoj tashti rrugëtimin tem prej fakultetit. Në fakultet në Beograd jom regjistru pa provim se ka qenë regjistrimi i atynve që e kanë pasë notat të shkëlqyshme pa provim, une i kom pasë krejt pesëqe, kurrë s’kom pasë katër në shkollë. Edhe kom qenë e treta në Beograd, me regjistrim edhe në kollokviume kom qenë shumë shumë e shkëlqyshme, se i kemi pasë profesorat në shkollë teknike shumë të aftë. Gjeodezinë, ka qenë ni, ni Delanin mbiemër kurrë s’e harroj, ai qaq mirë na ka mësu, me instrument, sikur kjo kamerë kështu {tregon në drejtim të kamerës}, teodolit¹ me punu.

¹ Teodoliti është një instrument optik preciz për matjen e këndeve midis pikave të dukshme të përcaktuara në rrafshin horizontal dhe vertikal. Përdorimi tradicional ka qenë për rilevimin e tokës, por ato përdoren gjithashtu gjerësisht për ndërtimin e ndërtesave dhe infrastrukturës.

Edhe në fakultet në Beograd, në punë praktike une kom qenë ma e mira edhe mu më kanë liru prej pjesës praktike për provim, vetëm teorinë, praktikën jo. E shumë shpesh më ka vy me spjegu kolegëve të cilët kanë kry shkollën, gjimnazin për shembull. Se me gjimnaz kanë regjistru të gjitha fakultetet. Edhe më vyke me... se ditën e parë edhe të dytë gati nuk kom pasë kurgjo të re me mësu, dy vjet në fakultet. Krejt ato unë i kom kalu në shkollë të mesme.

Kur kom absolvu, atëhere jom martu, domethonë pa diplomu, më kanë dalë shumë probleme, shumë telashe se shoku jem ka punu në Ferizaj, ka qenë arsimtar i edukatës fizike e une prej Beogradit kom shku në Ferizaj me jetu. Kom hi meniherë në punë se s'kanë pasë asnjë inzhinjer aty në firmën ndërtimore në Ferizaj. Meniherë kom fillu me punu, kom punu shumë aty në operativë.

Anita Susuri: Kisha pasë qef me u ndal te jeta ju j në Beograd gjatë studimeve, si ka qenë qajo periudhë?

Kaqusha Jashari: Kur kom shku atje, ajo ka qenë me '65-tën, '61-tën këtu e kom regjistru shkollën e mesme, me '65-tën, '66-tën e kom regjistru. Prej Kosovës aty kanë qenë... femër asnjë s'ka qenë, vetëm tre mashkuj që kanë vazhdu, mandej dy prej tyre si profesorë këtu në Prishtinë. Hamdi Sylejmani edhe Nijazi Hoxha, ata kanë qenë me mu studentë, po ata kanë shku nja dy vjet para, para meje, e kanë kry shkollën teknike në Mitrovicë dikun, jo në Prishtinë. Në Prishtinë kom qenë une gjenerata e parë. E jemi shoqnu atje në Beograd, na.

Erëmirë Krasniqi: A ke ndryshim i madh me shku prej Prishtinës në Beograd?

Kaqusha Jashari: Po nuk e di, zaher ky ndërrimi i vendit, jetës që kemi pasë përpara, jo Prishtinë, e Gilan, e Kamenicë, e Pejë, ka ndiku te na që kemi qenë si familje, pak ma lehtë e kemi pranu ndryshimin. Une në vitin e parë kom jetu në Beograd me ni dhomë me babën, se ai ka marrë ni dhomë privat. Po ka gjetë ma afër me pasë edhe une fakultetin po edhe ai punën, se ai me punë ka qenë në Beograd edhe kemi pritë me marrë banesën. Në vitin e parë kemi banu bashkë me ni dhomë.

Edhe shoqinë e kom pasë aty prej kahmosit, kanë qenë prej Sërbisë, kanë qenë edhe prej Bosnjës i kom pasë do shoqe të Bosnjës, që kanë regjistru fakultetin në Beograd. Se fakulteti në Beograd ka qenë ni fakultet i njohur i ndërtimtarisë se i ka pasë do profesora bajagi të aftë. Ni prej profesorave, nifarë Gjuriqi ka qenë projektant i asaj urës të famshme në Beograd që e lidhë Beogradin e vjetër me Beogradin e Ri. Qashtu që kanë qenë profesorë të aftë edhe kanë ardhë njerëz aty me studiu. Qendrimi i atynve ndaj meje nuk e kom vërejtë ndryshe se me tjerë si shoqni. Nuk e kom vërejtë që më kanë kqyrë ndryshe.

Mu më ka ndodhë niherë në ushtrime me m'u afri profesori i matematikës, nifarë Stipaniqi, u tutshim prej tij shumë se ka qenë i rreptë. Edhe t'u kqyrë qysh po punoj une, qysh po punoj une edhe më tha ni fjalë që thuhet ndryshe, une e kuptova e m'u duk që është shqip. A faktikisht ka qenë latinisht, po ka

qenë diçka e ngjashme edhe e mora vesh edhe vazhdova. Po kom pasë ni rast me to në provim, shumë të çuditshëm. I kom nxjerrë pytjet edhe e bona të parën, dytën, tretën, të katërtën hiç, as prekë s'e kom, s'disha.

Edhe ai e kqyrë të parën {bën sikur kontrollon me laps kimik}, dytën, edhe une t'u referu, t'u referu, të katërtën, "Çka osht' kjo?" Thashë, "Nuk di". "Kuku, qysh nuk din ti këto?! Qysh guxon mos me ditë, po këto ke mësu ti në gjimnaz!" Thashë, "Profesor une gjimnazin nuk e kom kry e kom kry shkollën teknike, po këto na nuk kemi mësu edhe nuk e di qysh e keni dhonë pytjen për diçka që ju s'keni ligjëru. Këto" thashë, "ju s'keni ligjëru".

"Çka?" Tha. Thashë, "Ju s'keni ligjëru këto". "Osht' e vërtetë" tha, "ti je shumë e rregullt në ligjerata. Osht' e vërtetë që s'e kom dhonë se kom mendu që ju duhet me ardhë të pregaditun në fakultet edhe me ditë këto". "Jo" thashë, "neve s'na kanë tregu në shkollë të mesme". Vetëm e ka marrë indeksin aty, "Dil jashtë" më ka qit jashtë. Kuku, kur kom dalë jashtë a u tranova, u tranova, qysh more me hup une, matematikë mos me dhonë provimin. A bash e kom ni veten që jom e aftë për atë, bile për notën kaluse. Kur kolegët e mi, "A shumë mirë që të ka qit jashtë" (buzëqeshë), "Qysh?" "Po ki kalu". "Qysh?" "Po kon e qet jashtë ka kalu" (qeshë).

Edhe përnime kom kalu edhe jo bash gjashqe, po pak ma shumë. Se kom qenë e singertë, edhe une kom qenë shumë e rregullt në mësim, nuk kom lëshu asni mësim, jo vetëm të matematikës po të gjitha, krejt i kom kalu. Edhe, edhe kom dhonë provimet rregullisht sikur tjerët, se për mu gjuha nuk ka qenë problem fare. Edhe nuk ka pasë shiptarë aty. Përveç këta dy që thashë Sylejman, ky Hamdi Sylejmani edhe Nijazi Hoxha, po edhe ata kanë ditë mirë. Na kemi qenë studentë të mirë atje, të mirë në Beograd. E kur u martova në Ferizaj, u dufke me udhëtu me dhonë provimet, shumë problem kom pasë, lindi ni çikë, e fëmija vogël e... Po edhe qajo periudhë shkoi.

E dikujt masandej i ka ra ndër mend që unë jom në Ferizaj e kom qenë aktiviste e rinisë. Po, Kaqusha Jashari, Kaqusha Jashari, more mos osht' Kaqusha Fejzullahu? E masandej më kanë thirrë edhe e kanë zbulu që une jom qajo. Edhe më kanë propozu me udhëheqë këtë sindikatën e ndërtimtarisë këtu {tregon mbrapa me gisht}. Edhe shoku, "O s'e kreve atë fakultet, s'e kreve atë fakultet!" Ai e ka kry Shkollën e Lartë Pedagogjike se s'ka pasë këtu edukatë fizike. "Po," thashë, "a po don me shku me kry?" "Po," tha, "i vetmi program që më përshtatet, që muj me vazhdu vitin e tretë Sarajeva". "Ani de" thashë, "ti shko në Sarajevë ma së pari kryje ti, mandej une diplomoj". Edhe shkoi në Sarajevë edhe këtu më kanë zgjedhë për sindikatë të ndërtimtarisë, ajo ka qenë me '75-tën.

Erëmirë Krasniqi: A erdhët mandej këtu prapë a, qysh ja bonët?

Kaqusha Jashari: Këtu jo, kom udhëtu. Jo, atje e kom pasë banesën në... të firmës në Ferizaj. Kom udhëtu, ma vonë e kom marrë këtë banesën. Edhe kom qenë aty prej '75-tës deri me '82-tën kur më kanë zgjedhë në parti. Domethonë, gati dy mandate kom qenë kryetare e ndërtimtarisë, edhe në qoftë

se e krahasoj punën ku kom kalu ma së mirti, une mendoj se puna në sindikatë ka qenë punë për mu ma me kënaqësi. Edhe në operativë të ndërtimtarisë me punëtorë, po sidomos në sindikatë, ka qenë në aktivitet.

Ajo ka qenë mas '75-tës, mas kushtetutës '74-tës, Kosova e ka pasë pak ma ndryshe statusin, e ka pasë mundësinë ndryshe. Fillun bashkëpunimi, universiteti i jonë me Tiranën, vishin profesorat këtu, une s'kom pasë kontakt me qat strukturë. Po, sa për punëtorë kemi pasë shumë angazhime për të drejtat e punëtorëve, për kushtet e tyre të punës, për... Kom shku shumë nëpër organizata ndërtimore, edhe "Izgradnja" në Pejë, jo "Kosova" e Vushtrisë, jo në Prizren ka qenë "1 Maji", Rahovec, "Dukagjini" në Gjakovë, "Ramiz Sadiku" firma ma e madhe këtu. Kam pasë shumë aktivitet, shumë. E masandej...

Erëmirë Krasniqi: A kishin të drejta punëtorët? A kishit ju punë në atë aspekt?

Kaqusha Jashari: Po, po, sa për të drejtat e punëtorëve ka qenë njëfarë marrëveshje e nënshkrime në nivel të Jugosllavisë për sindikatë. Edhe u dufke patjetër me siguru kushtet e punëtorëve në vendin e punës. Nuk kanë guxu me punu pa mbrojtjen. Këto nëpër skela me hyp, e këto s'ka mujt kërkush me shku pa u lidhë, pa qit *kacigën* [srb.: helmetën] {bën sikur vendos diçka në kokë}, pa teshat e punës. Masandej, ushqimi ka qenë obligativ në herë {ngreh gishtin tregues}, për orarin e punës ushqimi, po jo ushqimi i thatë, po kuzhinën.

Na i kemi organizu kuzhinat nëpër çdo objekt. Masandej edhe në punishte ku kanë punu jashtë vendit të punës u dufke patjetër me siguru fletjen, me siguru ushqimin. Qashtu që ka qenë, po thom, për mu ni, ni punë shumë e ndershme edhe ni punë që e kom ni nifare kënaqësie. E masandej kur erdhën ato problemet e '81-shës, shumë ka qenë problem i madh. Sidomos edhe në ndërtimtari, se krejt punëtorët e ndërtimtarisë kanë dalë në rrugë. Edhe u duft me shku në aktivitet me qetësu situatën, me...

Qashtu që kanë qenë mas '81-shës edhe ato qëndrimet e Komitetit Qendror shumë të rrepta, diferencimi, krejt ajo periudhë edhe mu më ka kap. Po une e kom pasë përmenda nonën shumë për edukim, po sa për punë jashtë shtëpisë e kom pasë babën ni këshilltar shumë të mirë. Mu baba më ka këshillu atëhere në sindikatë kur kom shku nëpër punishte me pasë kujdes çka flas, se kjo moskënaqësia ka diçka që ka nxitë njerëz. Masandej, ato qëndrimet që ke spjegimi "Kosova Republikë", parolla armiqësore, ka qenë ni spjegim pse osht' armiqësore, osht' shumë e rondë për me folë e mu më ka thonë, "Ik! Mos gabo me hi në atë temë!"

Se neve Fadil Hoxha... se ai shumë e ka deshtë Fadil Hoxhën, e përmenda që ka pasë edhe në luftë kontakt me to, ka thonë që, "Neve na takon po nuk osht' momenti. Qashtu që, ik se nuk osht' mirë. As nuk osht' mirë me denu njerëz për ato". Qashtu që, unë kom hi në grupe diferencimit, po nuk ka njeri që munet me thonë që une kom ndiku në përjashtimin e tij, qoftë nga puna ose nga partia. Jo, ato nuk

kom bo kurrë. Qashtu që edhe nuk më kanë caktu nëpër këto grupe se e kanë ditë që une nuk i dëgjoj shumë këto ndrrimet edhe nuk i zbatoj.

Po me '82-tën u dufke në parti, në kryesi të partisë me propozu edhe femra, e në, këtu në Komitetin Komunal kanë bisedu kush munet me qenë. E masi unë shpesh jom enë për shkak '81-shës, jo "Ramiz Sadik", jo nëpër organizata mu më kanë njoft aty, sidomos edhe përpara në sindikat, kanë propozu që osht' mirë mu me më kandidu. Edhe më kanë kandidu. E mu më ka ndodhë shpesh kështu nëpër këto struktura kur më kandidojnë, me më kandidu për shkak të përqindjes e cila nevojitet. Femra, prej prodhimit, inzhinjere, qashtu që kom qenë e përshtatshme, qashtu që mu më pranun në parti meniherë si anëtare e kryesisë.

Po ka qenë periudha shumë e vështirë prej '82-tës me i zbatu qëndrimet e Komitetit, me i përjashtu njerëzit, me diferencu, me... Po, shyqyr që kom shpëtu në atë kohë, nuk kom hy ktyne llugave. Me '88-tën, Azem Vllasi ka qenë kryetar dy herë ka ni mandat edhe ka ni vjet ka qenë me statut që s'munet ni kryetar me qenë ma shumë se dy vjet, një plus një. Edhe masandej bisedun kon me, kush me zavendësu, në atë grup prej katër vetëve kesh edhe une. I çun propozimet nëpër Komitete Komunale, të gjithë, shumica kanë qenë për mue, në krahasim me këta tjerë mashkuj.

Jonë pajtu në Komitetin Qendror meniherë, se asni grue nuk ka qenë në krye të partisë në asnjë republikë, kërkun. Edhe u gëzun, edhe plus në Kosovë, Kosova problem, që thojshin ni barut, *bure baruta* [srb.: fuçi me barut] që eksplodon këtu. Edhe femër edhe më propozun. Une në shpi gjithmonë jom konsultu me shokun edhe me babën të dytë aty, thashë, "Allahile çka me bo? Po më propozojnë qishtu".

Shoku tha, "Po mirë unë e di kush janë ata anëtarë aty, kush o ma i mirë se ti? Kërkush". "Le more ma i miri, a po e sheh çfarë shtate osht'?" tha, "Sikur për tjerë, si për ty, si për neve. Hiç s'bon me refuzu". Nuk refuzova, u zgjedha. Po kom qenë shtatë muj, u kundërshtova edhe me Millosheviqin u kapëm, u kacafytëm me fjalë, mirë që s'jemi kap fizikisht, se kanë qenë do situata qashtu afër, shumë të keqe, ka mujt, ka mujt...

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Kur filloi qekjo prezenca e Millosheviqit në Kosovë?

Kaqusha Jashari: Çashtja e Millosheviqin nuk osht' e lidhun vetëm me Kosovën. Në kryesi të Jugosllavisë, në kryesi të partisë kemi qenë të gjithë kryetarët e republikave edhe të krahinave, kanë qenë edhe tjerë, edhe ka ni ose ka dy, varet qysh e kanë përcaktu. Aty ka qenë, pos meje si kryetare edhe Kolë Shiroka anëtarë i kryesisë. E problemi kur ka fillu, ka qenë problemi që ka nxitë nacionalizmin sërb ky Millosheviqi.

Por, jo vetëm sërbeve në Kosovë, ai ka deshtë me Kosovën tash me tregu që osht' situata e vështirë edhe ka dashtë me i nxitë krejt sërbyt me u çu edhe me i mbrojt sërbyt e Kosovës edhe aty ka dalë ai problem që dojshin këta të Fushë Kosovës me shku në Bosne, me shku në Kroaci, me shku në Slloveni. Por, nuk kanë mri me realizu ato, ato e kanë realizu në Vojvodinë edhe në Novi Sad e kanë organizu ni tubim shumë të madh, prej këtuhit s'e di sa kanë shku. Edhe ka ra ajo struktura, dhanë dorëheqje, shkunë krejt.

Përndryshe, kanë fillu me mitingje me organizu si ni e drejtë e moskënaqësisë. Sikur tash që po thojnë demonstrata ka drejtë me u organizu, me paraqit, se osht' e drejta demokratike me demonstru. E në atë kohë kanë deshtë edhe mitingjet me i legalizu si mënyra e [shprehjes së] moskënaqësisë, a faktikisht ka qenë me tema nacionaliste, jo moskënaqësisë për jetë normale, po nacionaliste.

Këtu kur kanë fillu folshin që Universiteti i Prishtinës osht' bastioni i nacionalizmit shqiptarë. Shqiptarët, katunarët jonë shqiptarë të mirë, po profesorat janë nacionalistë. Ajo osht' një, një absurd, ku muret me qenë nationalist ni njeri intelektual, a ai që nuk din, nuk osht' i shkollum ai osht' i mirë. Domethonë, ti munesh me manipulu edhe lyp me manipulu me ni strukturë jo të shkollume, të padijshme, a nuk don me u kap me strukturë të dijshme e cila është për një jetë të barabartë edhe çka osht' kërkun në atë kohë, osht' kërkun ni jetë e barabartë për të gjithë edhe shqiptarët, mos me qenë në rendin e dytë.

Edhe për këtë temë kam pasë në Kryesi shumë diskutime, shumë probleme. Kur kom cekë atje edhe me argument, kjo ka ndodhë këtu kështu {numëron në gishta}, kanë kërkun këto, këto ka ndodhë këtu, në këtë miting kanë kërkun këto. Do ekcese ata vet i kanë bo për me fajësu shqiptarë, a vet kanë skenu, osht' ni strategji e tynve. Qashtu që në fillim pata une kritikë, qysh po thom qashtu. E niherë kur ka folë kryetari i Sërbisë nifarë Joviqi, në Zubin Potok, kur kanë qenë ndryshimet e kushtetutës si aktivitet, po ajo ka qenë kërkesa për reforma, po jo ndryshime për me marrë autonominë e Kosovës ose Vojvodinës, po ka qenë krejt qëllimi tjetër.

Ai ka folë aty edhe ato fjalët e tij i kom prezentu në kryesi se tha, "Sërbia, jo me qenë prej tri pjesëve, po Sërbia me qenë ni pjesë". Domethonë, mos me pasë kurrfarë autorizim, as policinë e vet Kosova, as Vojvodina, as mos me pasë, asni sen me vendos, as në kuvend, po krejt në Sërbi. E nuk besojshin. Tha, "Jo" tha, "s'osht' e mundur që ka folë ai". A për fat qat ditë në "Politikë" në listën, në gazetën beogradase, krejt fjala e tij aty {përplas dorën mbi dorë}. Edhe kur e pashë, thashë, "Në qoftë se nuk më besoni mue ato çka kom ni, merrni gazetën e sodit 'Politikën' edhe lexoni, qe fjalimi i tij".

Uh {onomatope} edhe ke ngat meje një malazez, një Vidoje Zharkoviq, ai ka pasë bajagi shumë ndikim në kryesi edhe ni malazez tjetër Marko Orllandiçi edhe ai. I thashë atina Zharkoviqit, thashë, "Merre lexo ti këto", kur e ka pa, {lëviz dorën horizontalisht} "Pushim po du, edhe stenogramin çka ka folë Kaqusha po du me pa". Edhe ata pushim, i nxerrën ata, i shkepën, ai po merr ato çka kom folë une

{shikon dy pëllëmbat e dorës}, po merr gazetën aty. Tha, “Qysh osht’ e mundun ky me folë qashtu”, thashë, “Une po ju thom që ky është rrezik shumë i madh”.

Kërkojshin miting në Fushë Kosovë këta sërëbët. Edhe me ardhë dikush prej Beogradit. Une normal që shkoj, kush me shku, kush me shku? Jo me shku filan-filani, jo filan-filani, jo kërkush nuk deshti. Une e propozova qat Marko Orllandiqin. Thashë, “Unë e propozoj, se ai ka ndikim shumë atje”. “Ani”. “Jo, une nuk muj se shumë smutë jom” edhe përnime ka qenë i smutë, temperaturë ka pasë, me temperaturë ka ardhë në Kryesi. “Une mendoj se ti duhesh me ardhë”, “E qysh une, po i smutë jom”. {ngrid supet} “Po më vjen keq, po atje nuk mundet gjithkush me shku”. “Ani”. Edhe ai me mue në kerr e në Fushë Kosovë. Shkumë atje. E kishin pasë bo binën ku me u çu me folë, tubim, njerëzit u tubun aty krejt. Sa kemi fillu...

Anita Susuri: Të ‘90-tën më doket ka qenë kjo?

Kaqusha Jashari: Jo, jo, me ‘88-tën kur më kanë hekë. Tubim i madh, sa u hypëm na, “Hajde me folë. Kush me folë i pari?” I thashë atina Orllandiqit, thashë, “Ma së mirti fol ti e masandej une e përshëndeti, une jom këtu” thashë, “ma mirë ti me folë”. “Ani”. Sa filloi me folë, njerëzit e kthyn shpinën {lëviz trupin anash} edhe fillun me shku tjetërkah, ka stacioni. Ai po kqyrë, po më kqyrë mue, {shikon përreth} po i kqyrë ata nejrëz aty, po çuditet, po folë, po s’po e dëgjon kërkush.

Kur njoni prej Fushë Kosovës po vjen te une, po thotë, “Duhesh ti me u lëshu poshtë se po të bojkotojnë, ty po ta kthejnë shpinën e jo këtijna”. Edhe une thashë, “Mirë”. Edhe une po nisna, ky po më kap për dore tha, “Ku po shkon?” Ky Orllandiqi. Thashë, “Unë po shkoj se po e kthejnë shpinën se jom une, vetëm ti me mujt me folë”. “Kush po thotë?” Thashë, “Qe, ky” {kthehet dhe tregon me gisht majtas}. Tha, “Qysh guxon ti kryetaren tonde me e zhdryp poshtë? Ajo osht’ edhe kryetare naltë e Kryesisë Jugosllavisë, sa jom une bashkë me to edhe plus e ki kryetare. Edhe kjo ka me dalë prej këtuhit kur dal une”. Edhe nuk më la. Shkunë. Edhe na metëm, as une me folë, çka me bo?

Hajde po shkojmë në Prishtinë në Komitet Komunal, hinëm aty. Edhe ky, “Ama informatën, ku kanë shku ata njerëz që jonë kthy? Kur, ku kanë shku?” Këta të Sërbisë janë ardhë grupi me kerr edhe janë shku atje edhe i kanë thirrë njerëzit në stacion të hekurudhës. A bina jonë ka qenë knej te ni shkollë. A nuk kom ditë, ky Orllandiqi tha, “Kur jom nisë kom thonë, ‘a po vini me neve?’ Kanë thonë, ‘Jo na s’po vijmë hiç, po ti shko!’” E kanë mashtru. Eh, edhe tha, “Po shkojmë,” tha, “në Beograd po shkojmë”. Shkumë në Beograd, u tubun ata që kanë qenë në punë profesionale aty, jo krejt kryetarët po ata që punojshin aty (qeshë). Edhe ky Orllandiqi tha, “Qetashti une flas e ti shuj” mu.

Edhe ai tha, “A din çka?” Tha, “Ato çka kom pa osht’ ma keq se ato Kaqa [Kaqusha] çka ka folë në kryesi. Shokë të dashtur na jemi vonu. Jo, ky që është nacionalizëm, po edhe ma zi se nacionalizmi serb. Kjo osht’ katastrofë. Na shkoi vendi, na shkoi Jugosllavia!” Nisi me folë njeri {prekë kokën me dorë}, tha, “Ato krejt çka kom folë fshini përpara, këto çka flas tani merrni se une ashtu mendoj. A ato

çka Kaqusha ka folë e pranoj edhe e nënshkruj. Se” tha, “ky është nacionalizmi sërëb edhe s’kemi me shpëtu prej tij”. E masandej fillun ata me mitingje, jo me shku në Bosne, jo kanë deshtë me shku në Kroaci, Slloveni, po ata i kthynë, sllovenët i kthyn këta. A në Mal të Zi e kanë majt edhe e kanë majt në Vojvodinë e kanë rrëzu strukturën edhe në Mal të Zi edhe në Vojvodinë.

Erëmirë Krasniqi: Për me i rrëxu strukturat u mbajshin këto mitingje, a për çka u flitke në to?

Kaqusha Jashari: U flitke se sërëbët e Kosovës janë në rrezik prej shiptarëve, krejt tema e rrezikut sërëb këtu. Por çka deshta me thonë, për këtë nacionalizmin sërëb nuk e kanë marrë këta as në Jugosllavi qaq serioz, se edhe kur kom folë nuk kom ni une qaq ni përkrahje, a dëshirën për me na ndihmu. Po krejt kom pa që ata po pajtohen, osht’ ajo po, i kanë kqyrë punët e veta, kanë deshtë diqysh me shpëtu vendin e vet. Kroatët kanë kqyrë qysh me u pavarësu, sllovenët kanë kqyrë qysh me u pavarësu, të gjithë. Bosna ka qenë shumë e koklavitun. Edhe kjo shpëtoi edhe Maqedonia me veprimin e atij kryetarit. Qashtu që na s’patëm mundësi, na s’kem... s’patëm as ushtri, as kurgjo {çon duart lartë}, durëthatë s’munësh me dalë me, me luftu. A këtë ushtrinë e kanë pasë në dorë mas vdekjes Titos sërëbët. E kanë marrë edhe punët të brendshme edhe, edhe ushtrinë. E qashtu, edhe në fund kujt i dul keq? Sërëbëve.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ju shkarkun? A mundesh me na tregu për qat moment, për presionet politike që i ke pasë?

Kaqusha Jashari: Une, mas krejt kësaj që ka ndodhë, une që kom kundërshtu shumë me Millosheviqin, jonë ulë këta në Sërbi edhe kanë thonë që duhet... me shkrim e kanë çu Komiteti Qendror i Kryesisë që une nuk jom e aftë me majt [nën kontroll] situatën në Kosovë edhe që une duhet me dhonë dorëheqje, edhe ato e ka nënshkru Millosheviqi. Une kur kom shku në mledhje ka thonë ky Shuvari ka qenë kryetar, ka thonë, “Hajde pak ma herët se po du me bisedu me ty”. Kom shku ma herët edhe tha, “Ta dish që ka mrri letra, qe ku osht’, lexo. Po kërkojnë dorëheqjen tonde”. Thashë, “Nuk, nuk du me dhonë dorëheqje. Ato meniherë po të tregoj se dorëheqjen nuk muj me dhonë se nuk kom faj une. Me pasë faj une po. Me majt situatën s’e di a munet dikush me majt se te na vepron nacionalizmi sërëb edhe aty osht’ shumë fshtirë”. Se krejt përshkruhet sikur që osht’ faji te shiptarët, a faktikisht te ata. “Qashtu që une nuk muj. Nuk du”.

Mu Millosheviqi më thojke, tha, “Krejt, krejt muj me thonë për tjerë, po vetëm për ty s’muj me thonë që je nacionaliste, irredentiste shqiptarë s’muj me thonë”. “Jo” thashë, “ato s’munesh me thonë kurrë, se une nuk jom. Me pasë nevojë me mbrojt të drejtën sërëbe kisha mbrojt. Kushdo që osht’ i shkelun” thashë, “i kom mbrojt të drejtat e punëtorëve në sindikatë, kisha mbrojt çdo të drejte. Po kësi hovi” thashë, “çka jeni tu bo, ku dona qaty kufinin kemi me qitë”. “Uuu” {onomatope} .

Qe në libër e kom qat tituj, kufini. Thashë, “Drejtat nuk munësh m’i shkelë. Qysh univerziteti ka faj për kuadrat shiptarë? Qysh drejtat tona... m’i fajësu shiptarët për çdo sen, ja-a”, “Organet s’funksionojnë

në Kosovë, organet kështu...”, “E çka me bo?” “Ti s’je e aftë duhesh me dhonë dorëheqje” “Jo” thashë, “une dorëheqje nuk jepi. Munët vetëm struktura e cila më ka zgjedhë mu me më hekë”. “Jo, na kemi me iniciu, une kom me iniciu” thashë, “E di, e kom pa atë letrën. Edhe në kryesi të Jugosllavisë u shqyrtue ajo. Une” thashë, “nuk jepi dorëheqje”.

Këta sllovenët, ky Millan Kuçani tha, “Une s’po du me u përzi në çashtjet e Kosovës, ajo osht’ çashtja e tynve”. Edhe kroatët qashtu, “Nuk du me u përzi”. Po me thonë që kom drejtë une, kërkush s’ka thonë. Edhe e formun grupin, erdh grupi këtu në Kryesi kërkun une me u largu, kërkun edhe Azem Vllasi me u liru prej antarit të Komitetit Qendror, se ka qenë vetëm anëtar i kryesisë se mandati i ka kalu, une kesh e para. Edhe u përhap nëpër gazeta, sulm, sulm, sulm mo... Edhe minatorët kanë vendos atje me...

Erëmirë Krasniqi: Me bo marshin.

Kaqusha Jashari: Me bojkotu, mbështetje. Më thirri në telefon drejtori Aziz Abrashi në zyre qat ditë para mledhjes. Tha, “Mos gaboni me dhonë dorëheqje se po vijnë minatorët. Kanë vendos me ardhë”. “Jo” thashë, “me dhonë une jo, vetëm a më lirojnë prej detyrës, a më hekin nuk muj me garantu. Çka di une kur hapët diskutimi, po me dhonë jo”.

Jo s’ja u ka ni hiç, ata u nisën para se që ka fillu mledhja e Komitetit. Une tu e majtë mledhjen, tu e hapë diskutimin, do shiptarë na mbrojshin neve, sërëbët na akuzojshin, aty mrena anëtarët. Edhe u bo situatë e ndame, kështu shiptarët me ni anë, sërëbët në tjetër anë. Sërëbët krejt me politikën e Millosheviqit. Edhe kur mrrinën minatorët qysh kanë mrrri, s’besoj që krejt në komë prej Mitrovicës, nashta edhe me autobusa. Kur mrrinën këtu, hinën në Pallatin e Rinisë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Kur lajmërun që minatorët kanë mrrri në Pallatin aty, atëhere u murrëm vesh aty në Kryesi, që kemi udhëheqë mledhjen me ndërpre edhe atje me shku se po më kërkojnë. Edhe shkova atje, po më dokët që ka qenë me mu edhe Remzi Kolgeci, s’e di edhe kush edhe ata nisoj ato, mos me dhonë dorëheqje. Ato kërkesa që i kanë bo ma vonë kur ka qenë greva, ato nuk kanë qenë atëhere. Po vetëm kanë qenë në lidhje me dorëheqjet tona, une thashë, “Nuk jepi dorëheqje”. Po ndërkohë kur jom kthy, Kryesia osht’ ndalë me diskutu për gjendjen, une ju tregova sa punëtorë jonë, plot salla edhe kështu kërkujnë.

Këta të Sërbisë kenë tre-katër, edhe këta të gjithë funksionarët tonë që jonë në Beograd në punë kenë aty, Kolë Shiroka, Sinan Hasani, Ali Shukriu. Edhe këta të Sërbisë aty, kërkujshin une me... këta të Sërbisë kërkujshin une me, me dhonë dorëheqje, une thashë, “Jo”. A në atë materialin që është pregaditë prej kryesisë jonë aprovu disa dorëheqje që kanë dhonë ma herët disa, Ekrem Arifi, Rrahman Dedaj, të gjithë shiptarë po edhe sërëbë kanë dhonë. Faktikisht kryesia ka qenë me shumë njerëz që kanë dhonë dorëheqje.

Edhe me aprovu ato, edhe propozimi që unë të lirohem nga detyra, se unë dorëheqje s'kom dhonë, po të lirohem nga detyra. A lirim nga detyra nuk ka në statut të partisë, ose e ki shkarkim, kur ki faj ose dorëheqje kur jep vet, a lirim nuk ekziston. Po qashtu kanë formulë këta në kryesi që unë të lirohem, kërkojshin aty. Thashë, "Une m'u liru jo", po thanë, "Kryesia po propozon që Komiteti me votu komplet atë propozim. Domethonë, jo veça veç, po komplet edhe ka qenë detyra që ma kanë dhonë mue aty. Edhe une kur kom fillu Komitetin me majt thashë, "Duhet me ma aprovu komplet këtë, këto propozime".

Edhe me ato propozime edhe une u lirova prej detyrës, kom majt fjalën që dorëheqje s'kom dhonë. Po mu më ka ardhë shumë, shumë keq që kolegët e mi shiptarë jonë pajtu me ato. Jonë pajtu se zaher e kanë pa që nuk ka rrugëdalje edhe jonë pajtu me qat propozim. E tashti u bisedu meniherë këtu para se që filloi Komiteti, nëse aprovohet kush me më zavendësu, kush me vazhdu. Edhe ni prej atynve anëtarëve, Husamedin Azemi, tha, "Hajde mo, çohu prej asaj karrike", thashë, "Une po e shoh që s'kom qare pa u çu, po vallahi ti me u ulë kurrë jo". Ato i thashë aty, se kom ni une në Beograd kush kish mujt me më zavendësu edhe përmenke pak emri tij. Thashë, "Ti me u ulë kurrë jo".

Do thanë, "Hajde Remzi, ti je kryetar i Kryesisë kishe mujt deri sa zgjedhet kryetari i ri ti me vazhdu. Nuk kundërshtoi ai, edhe ke aty nifarë mendimi që ma së mirti osht'... edhe une mendova që osht' ma mirë ai, se e kemi pasë ni bashkëpunim të mire me to, se tjetërkush prej atynve, se kanë dhonë të gjithë dorëheqje s'ka pasë kush. Azemi [Vllasi] s'kish mujt, s'ka pasë drejta. Ekrem Arifi ka dhonë dorëheqje, Rrahman Morina dorëheqje, tashti s'po më kujtohet kush osht' hala prej shiptarëve anëtarë të Kryesisë krejt kanë dhonë dorëheqje. Edhe atëherë dola para Komitetit edhe thashë, "Duhet me votu komplet, qashtu ka vendosë Kryesia".

Do pytshin, "E çka u bo me ty, e çka?" Thashë, "Komplet duhet me votu". Edhe në votime u aprovu qai propozimi komplet edhe une u lirova prej detyrës. E masandej, nesër ditën fillun prej krejt Kosovës me ardhë në Prishtinë. Shumë kanë qenë, në komë e në autobusa, me... qaq shumë njerëz që une, une jom tutë, me ju tregu të vërtetën. Thashë, "Çka ka me ndodhë?" E kur erdhën qaq shumë këtu në Prishtinë, i orientum ka stadioni, që aty me u mush stadioni a jo me nejt nëpër rrugë. Po në stadion hinën shumë. U dufke edhe atje me shku, u dufke atje me fol. Nuk po thom që kom rrejt, po edhe bash të vërtetën nuk kom mujt me fol, se u tutsha.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë fjalët e juja, ma konkretisht?

Kaqusha Jashari: Ma konkretisht aty ka qenë që duhet me e rujt qetësinë mos me ardhë deri te përllamja mes kombeve, sërbeve, shiptarëve, me rujt ni unitet kombëtarë për të mirën. Me i pranu reformat për mos me acarë situatën. Krejt në atë kuptim të qetësimi, të bashkëjetesës. Po s'ka mujt ndryshe me u bo se ka qenë, ashtu ka qenë atmosfera. Qashtu ka qenë edhe kërkesa prej Komitetit

Qendror. Vetëm ka qenë shumë e dukshme që ky nacionalizmi ka me i kushtu vendit komplet. Edhe qashtu ka ndodhë, qashtu ka ndodhë. Po tashti kujt i ka dalë ma së keqi? Sërbëve.

Erëmirë Krasniqi: A munësh pak ma shumë me na folë për qat takimin me minatorë këtu...

Anita Susuri: Në sallë.

Kaqusha Jashari: Në Pallat aty, po në Pallat osht'... kanë hi, kanë hi mrenda, kanë folë, kanë qenë të organizum. Kush me folë e, krejt kanë folë në atë kuptimin e mbrojtjes të kombit. Se nuk e kom ni une aty mbrojtjen personale, po kom ni nifare mbrojtjen e vendit, mbrojtjen e Kosovës që mu më ka ardhë mirë. Po me ju bashkangjitë atynve, tani kundër kujt jom? Nuk muj me qenë në krahë bashkë me moskënaqësinë të cilën e kanë shpreh nëpër mitingje që jonë nacionaliste. Domethonë, ka qenë ni situatë shumë e fshtirë edhe me u paraqitë qysh me folë.

Po pajtohesh me moskënaqësinë, a knej kundër kujt je, kundër nacionalizmit sërb? Edhe une ato e kom shprehë. Edhe niherë masi që ka ndodhë kjo, ni shoqja jeme, ajo ka ndërru jetë para disa vite, në Gjakovë ka qenë drejtoresha, arhitekte e Dukagjinit. Edhe u anku diçka për vendin e saj, se ka pasë me shku në Ent të Projektimit, tha, "Qysh s'po më pranojnë e qysh, e çka?" Thashë, "Behije" thashë, "une kryetare e partisë kesh edhe meta gjallë, punë e madhe për ni vend atje, ajde allahile, *aiii* {onomatope}". "Po, more" tha, "ty të kanë përkrah njerëzit shumë".

"Po, pse më kanë përkrah? as vet nuk e di për çka, përnime nuk di për çka". "A din pse? Ti folshe, une u zbrazsha". Ai osht' ai ndikimi te njerëzit, që domethonë kur kom folë e kom qëllu mendimin e masës, e për qato masa ka reagu. Edhe po ju tregoj të vërtetën kur osht' qetësu, e kom pasë nifare shprese që niveli i Jugosllavisë do ta merr diçka në dorë ma shumë, a jo me lonë veprimin e Jugosllavisë edhe Millosheviqit. Po nuk kanë ndërmarrë. Kur s'po flasin për veprimin e tyre... une mendoj që Raif Dizdareviqi, boshnjak i cili ka qenë kryetar i Kryesisë së Jugosllavisë në kohën e Millosheviqit, ka shumë faj. Se ai dilke me Millosheviqin me mbrojt Jugosllavinë.

Po me kon po don me e mbrojt, me Millosheviqin? A une, mu më ka ra në mend ni rast, jom taku në Budvë, në pushim me gruan e djalit të Sinan Hasanit. Ajo ka qenë vajza Senka, e Xhavit Xhabirit një funksionar të Mitrovicës. E ajo mu më thojke për Millosheviqin, se ka qenë situatë shumë e acarume, tha, "A din çka" tha, "çka më ka thonë vëllau i tij?" "Po?" Se ka punu në Ministri të Punëve të Jashtme në Beograd, kjo Senka më vëllaun e Millosheviqit. Edhe kur e kanë zgjedhë Millosheviqin për kryetar në Sërbi, i ka thonë asaj, "A di çka" tha, "po të tregoj, ai nuk e ka apetitin kaq pak" tha, "në Sërbi. Kur ka qenë fëmi kur i japshin ato detyrat me shkru ni tekst gjuhës" për shembull, ta jepshin ni titull edhe ti e shkrun, e ka qenë titull "Çka kom me qenë kur të rritem?"

Edhe ai ka shkru për veti çka ka qef me u bo. "Kur rritem" tha, "une në Jugosllavi kom me qenë Tito". Se Tito ka qenë i pari me shumë ndikim, e tha, "Kur të rritem une kom me qenë Tito". Ajo po tregon se

kur ka qenë i vogël, ai ka mendu me qenë i pari në Jugosllavi edhe ajo më ka thonë, kjo Senka për to. Si njeri ka qenë njeri që nuk ka ndëgju çka kush folë, po vetëm po mendon atë çka ai ka me thonë, a s'osht' me rëndësi çka dikush. Une hiç se ma në mend që Millosheviqin e kom pa me fletore ose me laps, ja-a, kurrë s'ka pasë ato. Ai vetëm folke, dëgjojke se s'pat qare, vetëm sa për me dhonë përgjegjen, sa për me ndiku.

Anita Susuri: Na tregut edhe për ni mledhje që keni fol ju, që ka dalë jashtë.

Kaqusha Jashari: Ah po, po shumë raste kom une me Millosheviqin. Kështu ka qenë situatë e fshtirë në Jugosllavi edhe në kryesi të Jugosllavisë na kemi diskutu për gjendjen. Edhe niherë kur ka qenë në lidhje me këto mitingje që kanë fillu me ecë herë ka Sërbia, herë ka Vojvodina, herë dojshin me shku në Bosnje, me shku në Jajce se ka qenë ni vend historik i ish Jugosllavisë edhe në Slloveni planifikojshin. Edhe na mledhjen qysh osht' situata e sidomos ju interesojke në Jugosllavi çka po bojnë këta sërbbët këtu në Kosovë.

Edhe na kanë bo rendin qysh kush me raportu, une kom qenë para Millosheviqit, ai ka qenë jo meniherë mas meje po ka qenë edhe ai mas tjerëve. Ajo nuk osht' edhe e rastësishme se gjithmonë ka qenë problem me sërbbë e kanë deshtë me ni qysh o situata me sërbbë gjithkund e në fund Millosheviqi. Edhe unë kam qenë diku e katërta sa po më kujtohet, e krytën do para meje e ai para meje i fundit që ke, Millosheviqi u çu ka dalë edhe une kom mendu që... bash e kom përcjellë se kom mendu që kthehet deri sa filloj une. Ai nuk u kthy edhe mu ma dha fjalën, atëhere Shuvari ka qenë kryetar, "Vazhdo ti".

Thashë, "Unë ju kisha lut me pranë kërkesën teme, kur vjen Millosheviqi une me folë se une shumëçka osht' e lidhun me situatën me Sërbinë" {tregon me gisht përballë}. "Me vend", edhe fillun tjerët. E mas nja ni ore a s'e di sa, ai u kthy edhe u ulë, kur u ulë pytke, "Ku ka mrri kjo procedura krejt?" Edhe thanë që e kanë njoftu, s'e di kush ke afër tina, që une s'kom folë. Edhe kur e kryti diskutimin e fundit mu ma dha fjalën ky Shuvari, une fillova. Sa kom fillu prej nervozës u çu edhe filloi me ecë rreth e rrotull. Edhe p'e shoh po ecë, ai duhet me u ulë edhe më ndëgju.

Une u nala edhe mu po më thotë Shuvari, tha, "Pse je nalë?" Tha, "A je mirë ti?" Thashë, "Jo, une mirë, po une u nala se derisa Millosheviqi shëtitë s'muj me folë, duhet me u ulë dikun me ndëgju". Edhe ai tashti s'dike ç'a me bo {shikon herë në njërin anë, herë në tjetrën}, a me u kthy te vendi vet, a me vazhdu? A ka qenë bash mrapa kryetarit edhe e gjeti ni karrikë të zhbrazët u ulë aty me Shërbimin e Komitetit Qendror. Edhe une vazhdova e kreve, po nisën njerëzit mes veti me folë edhe me keshë ka pak, se Millosheviqin me mashtru edhe me ndiku, pak për tjerë ka qenë edhe e guximshme. Edhe nuk kishin vepru qashtu, se kanë pasë kujdes ndaj tij mos me u kapë, se i ikshin për lamjes me to. Thojnë që nuk ka të drejtë po me hi me to rrallë kush ka guxu.

Edhe (qeshë) e ndërprejtëm, pushim ke, e ni sloven Franc Shetinc u afru tha, “Valla çka e ke bo këtë shtos” tha, “me pasë planifiku s’kishe mujt me realizu tha, “Shumë, shumë e qëllume”, e më lavdoi ky sloveni. Po, po thom në veti masanej tu mendu, po ti po lavdron kështu, po pse në mledhje nuk folë?. Qashtu edhe ky kroati Raçani, “Au sa mirë ke”, po pse s’po folë në mledhje? Çka po më vyn mu me më tregu në pushim që jom me ty, kur ti nuk më përkrah atje.

A i vetmi njeri që ka folë kundër Millosheviqit osht’ i Vojvodinës Boshko Kruniqi, anëtar i kryesisë. Domethonë, kanë ni problemin e Vojvodinës që autonomia do të shkon sikur që ka ndodhë, po na bile e fitum shtetin, na s’jemi dorëzu, a Vojvodina u dorëzu komplet. Komplet, tash osht’ pjesë e Sërbisë pa kurrnifarë kompetenca. Qashtu që une kom nejt në kryesi hala, mu më kanë hekë prej vendit si kryetare, po në Kryesi jo. Por kur kanë fillu vlerësimet për ngjarjet s’kom mujt me u pajtu me shumëçka aty, me vlerësimet hiç s’kom mujt me u pajtu. Edhe kom pa që jom gjithmonë në kundërshtim tashti, jo sikur përpara me politikën e Beogradit po kom ardhë në situatë me vlerësimin i cili ipet aty në Kryesi të Partisë edhe vlerësimi jonë edhe jom edhe pjesë e asaj. E kur e pashë ato atëherë dhashë dorëheqje {çon dorën lartë}. Thashë, “Nuk muj mo me...”

Erëmirë Krasniqi: U tërhekët krejt?

Kaqusha Jashari: U tërheka prej Kryesisë, erdha në shpi kom nejt nja ni mujë a s’di sa. Zakonisht interesohen për vazhdimin e punës jo vetëm për mu. Po zakonisht kur kalon mandati pysin, “Çka po bojmë ma tutje?” Edhe une kom pasë kështu ni orientim ka ekonomia. Edhe atëherë deri sa kom nejt në shpi më ka ardhë në shpi ni shok i gjeneratës babës tem, nifarë Qerim, Qerimi i Vitisë, ka thonë, “Ti çka ki me bo ma tutje?” Thashë, “Nuk e di ose në Odë Ekonomike ose dikun që osht’ e lidhun me ekonominë. Si inzhinjer kom punu në prodhim” thashë, “dikun”.

Tha, “A bon ti me ardhë në vendin tem?” “Ku bre?” “Në Drejtori të Rrugëve, une kom me shku në pension edhe gjashtë mujë. Une gjashtë mujë rri aty si këshilltar. Lypi me ardhë ti, aty osht’ vendi për inzhinjer”. Thashë, “Mu po më vjen shumë keq, ti je aty, qysh me lypë?” “Hiç, të thashë une, edhe gjashtë mujë në pension po shkoj”, i vjetër. Edhe kom shku te Jusuf Zejnullahu, ka qenë atëhere kryetar i Këshillit Ekzekutiv, Jusufi. Thashë, “Jusuf, kështu, kështu në Drejtori të rrugëve kisha shku”. “Jo” tha, “s’ka problem hiç”. Pa procedurë më kanë emëru atje, nuk ka qenë drejtorja po ka qenë BVI-ja. Atëherë BVI kemi pasë, BVI-ja e rrugëve.

Edhe u zgjedha aty, deri sa kom ardhë une, ky Qerimi blejti kerrin e ri. Thashë, “Pse?” Se hala s’kom fillu, po kom ditë. Tha, “Me bo me ble ti, meniherë thojnë, ‘Qe ka ble, ka ardhë edhe meniherë ka ble’”. A pare ka pasë drejtorja shumë për ndërtimin e rrugëve, se nuk ka shku prej buxhetit si tashti, po ka qenë përqindja e caktume prej shitjes benzinit. Edhe çdo pumpë, firmat që mirren me naftë përqindjen e shitjes pesë përqind, a s’e di sa në llogarinë e drejtorisë. Edhe drejtorja masandej me ato pare ka majtë, ka ndërtu rrugë, ka mirëmbajt rrugë e krejt, ka pasë pare shumë edhe ai e blejti kerrin. E tashti,

une e kom pasë ni tjetër qasje në punë, une kom deshtë me ndërtu qaq sa ka pare. A përpara këta që kanë qenë para meje kanë ndërtu aty ku duhet, po jo sa kanë pare.

Qashtu që drejtorja gjithmonë ka pasë shumë pare, ma shumë pare se sa ka qenë puna. Edhe kom nejt aty ni vjet, jo ma shumë. Ke greva e sindikatës edhe na bisedum çka me bo. A me bo qat ditë grevën apo mos me bo? Sikur sindikata që ka lyp prej krejt punëtorëve, se kanë fillu me i ndrru drejtorat krejt me rend, edhe me siguri e kom ditë që vjen rendi edhe te une. Thashë, “Po marrmi pjesë po e pashë une, çka po rri në parti kur nuk po pajtona me Rrahman Morinën e punën e tij. Edhe bisedum edhe e dhamë krejt librezën, krejt drejtorja e partisë dulëm. Në Komitet e çoi ai sekretari i partisë ni inzhinjer, i çoi librezat edhe kom dalë prej partisë.

Kom kajtë për me hi në parti, a e kom dhonë vet [librezën]. Këtë detaj që kom kajt nuk ju kom thonë qysh jom pranu. Tashti po ju thom, në shkollë të mesme në vitin e katërt zakonisht i marrin disa nxanës të mirë për partinë, e pranon organizata. Edhe atëhere une kom qenë Kryetare e Rinisë e mu s’më kanë propozu i kanë propozu do shoqe të mia, tre shoqet edhe dy shokë, me i pranu a mu mos me më pranu në parti. Edhe kom reagu, kom shku te drejtori, “Qysh mu mos me më pranu?” “Po na për shkak rastit që e patëm”. E kemi pasë ni rast disa mujë ma herët, ni grup, dy-tre vetë prej shkollës kishe kanë qenë anëtarë grupit ilegal në Podujevë e kanë qit flamurin {ngrid dorën sikur mban diçka} në xhami, kuq e zi.

Edhe ata nxanës i kanë shënu edhe po dojnë me i përjashtu prej shkollës. E në atë grup kush me qenë, ni shok i jemi, ni shok i ngushtë. “Qysh bre ti Shemsi, çka ki bo ti këto?” “Hiçu more ktyne, çfare!” “Kuku”. Edhe unë e kom mbrojt ato, “Këto s’guxoni me përjashtu, ky osht’ nxanës i mirë, aktivist i mirë, anëtar i Rinisë, anëtari te na në kryesi të shkollave, qysh me përjashtu?” Edhe kom kajt në mledhje edhe ata për shkak gjestit tem, pse me kajtë për këto, nuk më kanë propozu në parti. Edhe shkova te drejtori, ka qenë njëfarë sërbi, Saviqi. Thashë, “*Direktore*, drejtor” thashë, “une mos me qenë anëtare e partisë a me pranu tjetërkon, a une kryetare” thashë, “nuk osht’ në rregull. Ta dijs” thashë, “rregulloni këtë punë”. E kur kom dalë t’i kom mshu derës ka kërситë shkolla.

E më ka pa ni mësuse, ni arsimtare sërbe, më ka dhonë ekonominë politike, “Çka ka Kaqa? Çka osht’ bo këtu? Çka po bërtet ti?” “Qysh mos me bërtitë” thashë, “s’më kanë pranu në parti, e kanë pranu tjerë, a une kryetare e partisë, rinisë”. “Kush s’të ka pranu? Te na në shkollë? S’jom konë une në mledhje, s’munët qashtu, hiç mos u mërzit une e rregulloj këtë punë”. Përnime, në mledhjen e ardhshme ajo më ka propozu edhe më kanë pranu në parti. Edhe në shpi i thashë babës për rastin e Shemsijës e kështu. Tha, “Oh, qy çka po të thom” tha, “këto senet kanë me shku edhe ku me ditë çka ka me ndodhë hala po kurnifare, asnji individ s’munët kurgjo me bo. Mos mendo që ti mundesh me bo diçka për kolegun tond në shkollë. Në qoftë se e ka kap institucioni s’ka” tha, “aty shpëtim”. E qashtu që kom kajt, po kur e kom dhonë librezën s’më ka ni. S’po pajtona edhe në rregull.

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë e zakonshme me dorëzu librezën?

Kaqusha Jashari: Po, atëhere po të gjithë, *aaa* {onomatope} ka qenë në mënyrë masive dorëzimi i librezës, sikur kur ka qenë anëtarësimi masiv në LDK. Edhe a din qysh ka bo anëtarësim LDK-ja, krejt organizatat themelore të Lidhjes Socialiste nëpër katune që kemi pasë gjithkunj, jonë shëndërru në LDK, eh. Une vet këtu para Pallatit të Rinisë, kur ka qenë regjistrimi për LDK-në, une aty jom regjistru. Kur kom dhonë këtë librezë, aty jom regjistru. S’e di a ekzistojnë ato libra dikun, aty jom regjistru. Po nuk kom qenë aktiviste e LDK-së, se mas formimit të Partisë Social-Demokrate, ajo ka qenë shumë shpejt, me ‘90-tën.

Pjesa e Katërt

Erëmirë Krasniqi: Qysh vendosët me formu një parti të jujën? Po mendoj, po e kuptoj që ndodhi pluralizmi po...

Kaqusha Jashari: Na, shiqoni diçka edhe sa ka qenë Partia Komuniste, ka qenë iniciativa e reformës mrena partisë, për me bo ni shoqni plurale. Na kemi pasë aty ni profesor, Kadri Metaj, i cili ka qenë anëtar i ni grupit në nivel të Jugosllavisë. Anëtar i jonë nga Kosova në atë grup lidhur me ndryshimin mrenda partisë. Domethonë, ka fillu iniciativa për ni jo shoqni totalitare po me qenë pak ma liberale e qashtu. Masandej, mas shërbërjes së partisë, se në vende tjera janë shndërru në parti social-demokrate ose socialiste, ato parti komuniste. Vetëm e kanë majtë mledhjen edhe kanë kalu, te na s’ka ekzistuar mundësia se u shpërnda. Jonë dhonë librezat edhe s’ke pasë çka me...

Edhe atëhere kur thashë une që kemi bisedu, a me marrë pjesë në këtë thirrjen e sindikatës për bojkot, mos me punu ni ditë? U murrëm vesh që po. Po në atë kohë unë e kom ditë që s’kom me qenë këtu se unë e kom pasë të caktume në Francë, në spital, ditën e operimit të vajzës, që e kom pasë smutë. Edhe u dufke me shku, s’e di sa më kanë lyp. 15 ditë ma herët po më duket me shku për shkak pregaditjes trupore. Edhe une thashë, “Nuk jom aty”, në fillim të shtatorit ke, “por, mu vetëm më qitni në atë listë që edhe une jam pjesëmarrëse, ani që s’jom këtu e nënshkruaj kur duhet”. Qashtu që jom llogarit sikur që jom pajtu me qat rastin e sindikatës. Edhe kom qenë atje në Francë kur ka qenë këtu me 8 korrik, kësi shtator a kur ke ajo greva komplet...

Anita Susuri: Në shkurt?

Kaqusha Jashari: Jo, jo, ajo ka qenë e para në shtator, ato jom e sigurtë se une jom nisë në Francë, para asaj date a në tetor vajza ka pasë operacion. E qashtu që, si pasojë i kanë përjashtu masanej njerëzit prej punës. Une kom qenë në spital kur më kanë thirrë prej drejtorisë, tha, “Ty të kanë përjashtu, ka ardhë drejtori i ri”. Thashë, “Ani, veç” thashë, “mos gaboni ju me lëshu punën. A në qoftë se ju përjashtojnë, s’keni çka boni. Vetëm në qoftë se s’ju përjashtojnë, ju vazhdoni”. Edhe kur jom ardhë mas nja ni muj dite që kom qenë në spital, kur kom ardhë këtu drejtori i ri ka qenë. Edhe disa inzhinjerë që kanë qenë si udhëheqës si shefa, i kanë përjashtu, të tjerët nuk kanë dalë prej punës. Se

thashë, “Ju as nuk më keni zgjedhë, as me përjashtimin tem ju s’keni faj edhe” thashë, “mos gaboni me dalë me hup vendin e punës, rrogën e këto”. Qashtu që, drejtoria ka vazhdu me punu.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e kanë arsyetu atë vendimin?

Kaqusha Jashari: Aktvendimin kurgjo, vetëm e kanë... mu më kanë shkarku e ka ardhë ni drejtor i ri, e kom njoftë unë atë djalit, inzhinjer, kolegë. Po baba i tij ka qenë një kohë funksionar po u konë njeri i mirë, i Gilanit. Qysh... kom harru mbiemrin... Cuckiq, ka qenë njeri i mirë, u shoqnu edhe me shqiptarë e me babën tem e krejt, po njeri nuk e din kur vjen situata qysh njeri sillet. E djali vet ka ardhë aty edhe kom marrë vesh une. Edhe nesër dite une shkova në punë para kohës, jo kur fillon puna po para kohës kom hy në zyre. Edhe jom ulë si drejtor aty. Po vjen ky, po hin mrena {shikon sikur është e nevrikosur}, po më kqyr.

Tha, “Ti nuk e din se ty të kanë shkarku?” Tha, “Mu më kanë emëru”. “Po” thashë, “kom ni, po une kom ardhë me ta dorëzu detyrën”. “Çfarë detyre dorëzim?” Thashë, “Dorëzim, kur udhëheqësi shkon e tjetri vjen, duhet me ja dorëzu detyrën, se une kom çka me të dorëzu. Punimet ku kanë qenë, vazhdimi ku, çfarë kontrata. Rendi osht”. “Jo”, tha, “s’ka këtu. Këtu osht” tha, “kjo osht” tha, “vendi, Sërbia osht’ këtu”, ai mue. Thashë, “Le ti politikën, tash s’ka lidhje çka je tu folë. Jemi tu folë për drejtorinë, a osht’ Sërbia, a osht’ Kosova tjetërkush vendos. As ti, as une”. Thashë, “Drejtoria, une po du me ta dorëzu detyrën”.

“Jo” tha, “une e kom pranë edhe kom fillu”. E une në vendin tem si drejtoreshë ulun, ai u ulë aty {tregon me dorë përballë} në fotelë, aty. Po e çelë këtë çantën, katrore {përshkruan me duar} e ka pasë, ni çantë. Kuku, une thashë çka po nxjerrë, mos ka naj allti najsen (qeshë), p’e nxjerrë alltinë (qeshë). Thashë, “Une me u çu prej këti vendit jo deri sa nuk ta dorëzoj se e kom” thashë, “nëpër fioka këtu senet e mia”. Kur p’e çeli çfarë fioka krejt i kanë zbrazë i kanë qit me ni çantë, i ka renditë aty krejt. Edhe thashë, “Bre ti... Zhivko” emrin, Cuckiq. Thashë, “Bre, Zhivko” thashë, “ky baba yt u shoqnu me babën tem edhe ta kom njoftë babën. Edhe e di që i ka mëshu harmonikës”.

“Po” tha, “po e man në mend”, “Po” thashë, “kemi shku edhe në piknik, me harmonikë baba yt ka qenë. A din çfarë kongë ai mshojke edhe shqip, e sërbisht e, ka qenë shumë njeri i mirë. E ti tash” thashë, “po vepron sikur Millosheviqi me hekë e me...”. Tha, “Qashtu ka ardhë koha. Po, po, ka ardhë koha” thashë, “Cila kohë?” “Koha e Sërbisë”. “Po, a?” Po thashë, “Kqyre çka po të thom, me konë ki me pi kafe ti tash këtu, a ki naj shok këtu prej drejtorisë me porosit kafe edhe me u ulë në këtë drejtori me pi kafe?” “E pse?”, “Po” thashë, “une ma së pari që po të ngjof edhe e di ku ke punu në ‘Binačka Morava’ në Gilan e, jemi taku. E une tashti për qef nuk ulna me ty me pi kafe. A e ki naj shok” thashë, “me u ulë me pi kafe?”

Thashë, “S’ki. A e din çfarë jete osht’ pa shoqni? A je tu mendu” thashë, “pak”. Kur ka thirrë sekretarëshën, e ka ndërru sekretarëshën, një sërbe. E thirri, {bën sikur frikësohet} “Drejtor, urdhno

drejtor”, “Ni apaurin”. Kuku, apaurin kom ni që o për qetësim, po me përdorë kurrë s’kom përdorë kurgjo. Dul ajo, po edhe ai nuk priti dul me ato. U kthy, apet çantën e çeli, kuku thashë, mos ka naj allti se me alltia kanë qenë krejt, me armë. Kurgjo, u çu. Thashë, “Une po dalë poshtë me kolegë me inzhinjera, a ti ulu lirisht vetëm, detyrën s’ta kom dorëzu ta dish”. “S’po më vyn”. Edhe une shkova poshtë, nejta me kolegë, nejta, dola. Nesra apet erdha aty e ma prunën vendimin. Aty shkrujke që ma gjatë s’kom qenë në punë edhe po konsiderohet që e kom lëshu punën.

A kur e mora ato, shkova apet te ai, thashë, “Gabim e ke shkru se une fitoj në gjyq, se une për çikën që kom shku në Francë une e kom vendimin e komisionit. Ti po mendon që une kom shku kështu. E kom komisionin që më kanë leju për mjekimin në spital. Nuk...”. “Për mu” tha, “s’ke qenë në pune edhe je përjashtu nga puna”. Edhe qashtu, kom ardhë mandej në shpi, s’e kom pasë vendin e punës, kom nejt këtu. Edhe u formu Partia Social-Demokrate. Më thirrën, “A po don me u bashkangjit?” Thashë, “Po”. Edhe ashtu kom mendu me formu une, social-demokrat kom mendu, se kom folë me ato të Kroacisë, me Ivica Raçanin kom folë me to për statut e këto me më ndihmu. Ka thonë që, “Kur dush hajde t’i jepi ose t’i çoj”. Po masi e formun, më thirrën, “A po don?”

Erëmirë Krasniqi: Kush e ka themelu?

Kaqusha Jashari: Hë?

Erëmirë Krasniqi: Kush e ka themelu partinë?

Kaqusha Jashari: Kanë themelu do profesora me iniciativën e Fehmi Aganit. Se Fehmija ka qenë social-demokrat, por në LDK ka fillu e ka metë. Kadri Metaj, Ramush Mavriqi, Anton Berisha, ky avokat Demiku, Fehmi Rexhepi gazetar, ai vdiq. Baba i asaj që është në KTV, “Desku” që e ka udhëheqë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Kaqusha Jashari: Qashtu që mirë ka qenë ajo parti, ka pasë bajagi kuadra, Palok Berisha. Po s’kemi pasë përkrahje, për vota ndryshe luftohet, me pare, me blerje, me tona. E na s’kemi qenë parti që jemi marrë me pare, me përkrahje financiare me kërku, jo. Qashtu.

Anita Susuri: Qysh kanë vazhdu vitet e ‘90-ta? Shumica e njerëzve...

Kaqusha Jashari: Prej ‘90-tës masandej si Parti Social-Demokrate kemi punu mjaft. Une kom qenë anëtare deri ‘98. Ka qenë Luljeta Pula në fillim, ajo ka kriju do probleme mrenda partisë, do mospajtime me do anëtarë, por ka dalë. Ka mendu, une jom partia, nuk osht’ kjo partia. Na e kemi majtë të veten. Me ‘98-tën une jom zgjedhë deri 2008-tën kom qenë kryetare, kom pasë do koalicione, mirë kemi kalu. Me PDK-në kom pasë niherë koalicion, bash atëherë kur u shpallë Kosova shtet. Jom

nënshkruse e deklaratës. Në qoftë se ka ndodhë diçka e mirë në politikë, ajo e mira osht' se jom në atë grup të nënshkrimeve që kom dhonë.

Por tashti mendoj se, edhe me do të ri tashti që kanë ardhë ma ndryshe mendojnë, po jam anëtare e kryesisë. Kom vazhdu me jetën normale, kom dalë në penzion kur i musha 65 vjet, qetashti dhetë vjet që jom në penzion. Po mirrem me ato çka më pëlqen. Kom pasë pikturën gjithmonë si hobi, kom vazhdu. Qe i keni këtu punimet {tregon me kokë përballë} që i kom bo për ekspozitë, kom pasë pesë ekspozita personale. Tash e kom ni shansë me i çu jashtë niherë, kurrë s'kom mendu me bo ekspozitën jashtë. Tashti në Zvicër mund të ndodhë, nuk jom e sigurtë hala. Gati i kom, në qoftë se bohet mirë.

Penzionin e kom si të gjithë. Njerëzit po mendojnë që e kom ni penzion ma të madh ose privilegj, ose... nuk osht e vërtetë. Une jom me ato kriteret e ligjit. Me fakultet edhe me përvojë minimumi 15 vjet në të kaluarën, une në të kaluarën kom shumë ma shumë, po kom hi në atë kategori të kontributdhënësve. Qashtu që, me fakultet edhe me qat përvojë i kom 260 euro. Qajo osht', qato jonë të ardhurat e mia.

Erëmirë Krasniqi: A mujm me folë nashta edhe pak për zhvillimet e '97-tës, '98-tës edhe lufta që vjen '99-tën. Qysh ka qenë jeta juj atëherë?

Kaqusha Jashari: Prej themelimit të partisë deri me '98-tën kur më kanë zgjedhë si kryetare e kemi pasë aktivitetin me të gjitha partitë politike në Këshillin Drejtues, Këshillin Koordinues, jo drejtus, të partive politike ku kanë marrë pjesë të gjithë, kryetari ka qenë [Ibrahim] Rugova. Aty kanë qenë Partia Liberale, Gjergj Dedaj; Partia Demokristiane, Mark Krasniqi; Social-Demokrate, une; edhe partitë tjera Republikane. Masandej jonë formu edhe do, do tjera jonë nda e çka di une.

Qashtu që, na e kemi pasë ni koordinim edhe ni bashkëpunim me LDK-në, që a kanë organizu ata apo kanë kërku përmes tynve nuk e di, vetëm shumë kontakte me ndërkombëtarë kemi pasë. Me Riçard Hollbrukun i cili vdiq, me Kristofer Hillin, me shumë ndërkombëtarë. Na kanë majtë, na kanë sugjeru, kemi bisedu, kemi marrë informata edhe gjermanët kanë qenë mjaft këtu. Domethonë, ka qenë ni, ni jetë, ni... qysh me thonë organizimi paralel i këtina organizimit që ka pasë, që ka pushtu Sërbia.

Na kemi pasë veç edhe sportin, për shembull federatat kanë funksionu, arsimi ka funksionu. Ka funksionu "Nana Terezë", shëndetësia përmes tynve. Do organizata humanitare për ndihmën e këtyne, të popullatës. Ato postbloqet Sërbia i ka pasë. Me tregu të vërtetën sa për luftën Partia Social-Demokrate ka dalë e para që e përkrahim të drejtën e mbrojtjes së pragut, qashtu kemi thonë, pragut të shtëpisë. Bile edhe titulli ka dalë në gazetën "Bujku", ka bojkotu, ka publiku. Edhe kemi pasë informata të sakta, se na e kemi pasë degën mjaft të fortë në Skenderaj. Atje e kemi pasë Nazmi Xanin si kryetar, por jo themelus, themelus ka qenë ni njeri i cili ka vdekë ma vonë, ni Sadri Hajraj, Nazmi Xani ka qenë.

Po ajo që ka ndodhë në Prekaz, na e kemi pasë ni përcaktim në konferencën zgjedhore bash atëherë kur ka ndodhë masakra e këtyne Jasharajve. Kur ka qenë në shkurt ni sulm i parë që kanë qenë të plagosune dy vajza, na kemi shku me vizitu, na ka pritë ky kryetari degës edhe kemi shku atje në odë, une jom pa me babën e tynve, me atë Shabanin, me nonën. Me këta dy, me Hamzën edhe Ademin jo se ata s'kanë qenë aty, ata tjerët të familjes po. Edhe më thirrën ato gra edhe nona e tynve, "Hajde me pa ku kemi qenë na kur kanë sulmu këta". Edhe më çunë në tjetër objekt.

Dulëm prej odës {tregon me dorë} poshtë edhe ajo grua shkojke ma shpejtë edhe une s'e pashë ku shkoi, edhe mendova që osht' knej {kthehet majtas}, e u ktheva këtu, {vendos dorën mbi ballë} kur kom pa aty armatim. Kur i kom pa, a din ato kështu {përshtuan me duar} si raketa, s'e di qysh thirrën, të gjelbërta të gata. Kur i kom pa u trondita aty, vetëm kom metë, ajo tha, "Hajde, hajde" edhe une shkova masandej. Kuku, mos vet sa osht' ajo aty, për çka qysh, nuk e di. E shkova në objekt tjetër me to, më çoi në kat aty edhe i kom pa krejt shenjat e plumbave nëpër mure {përshtuan me dorë}.

"More qysh ju?" A krevetat të nalta jo kështu, po interesant një metër. "E aty jemi renditë, aty kemi flet, po kur ka fillu" tha, "u lëshum poshtë përfundi dritareve". Edhe qashtu kanë shpët, a dy vajzat kanë qenë të plagosuna i kanë çu dikun në shërim s'e di. Edhe qashtu që interesant edhe shum me kerr, na çoi ai i Drenicës, i Skenderajit ai kryetari, aty shumë njerëz kanë ardhë me i pa. I kom pa tenkat, po s'na ka nalë kërkush. Zaher kanë pa që shumë njerëz po vijnë edhe nuk kanë ndërmarrë se posti i policisë ka qenë edhe ushtrisë po nuk na kanë nalë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë në qat kohë me i kalu postbllloqet, sidomos ju që keni qenë një figurë...

Kaqusha Jashari: Po nuk kom kalu, nuk kom lëvizë une jashtë Prishtinës. Vetëm ky rasti i Skenderajit, se kështu nuk kom kalu. Aty me siguri i kanë kontrollu komplet, ku me ditë, nuk, nuk kom kalu. Nuk di, ka qenë ni atmosferë s'e di s'keni qenë në atë kohë, ka qenë ni atmosferë shumë e ronë, shumë... *eihh* {onomatope}. Une e di vetëm kur kanë organizu këta, se shokun e kom pasë kryetar të Federatës të Notit, kur i kanë organizu garat e notit, e kanë shku në Batllavë atje me organizu. Kuku sa policë kanë qenë mrapa tynve, me pa çka po ndodhë, not {çon pëllëmbën}. Qashtu ka qenë edhe për futboll edhe për këto tjera, shumë, shumë fshtirë.

Po interesant sa për donacione, se u dufke edhe do shpërblime me dhonë e ka kushtu, a din se kushtojke edhe udhëtimi garusëve edhe krejt, nuk ka pasë problem, firmat japshin ndihma. Unë e di krejt kush ka dhonë, po ato nuk jonë pare të mëdhaja, ato jonë pare ka niqin marka, marka ka qenë atëhere, ka dyqind marka po kanë pasë mjaft për me organizu. A na e kemi majt ni dyqan, kemi jetu prej punës tonë, kemi pas firmën. Dyqan mrapa teatrit me qira, pajisje sportive, se shoku sportist edhe ai dike me zgjedhë këto paisjet. Prej asaj kemi jetu edhe ka qenë tre për qind prej shitjes në fond, ardhke dikush aty tre përqindëshin për arsimin edhe për nevojat e pushtetit paralel. Ato rregullisht i kemi dhonë.

Po ka pasë problem shoku jem masandej, se masi patëm na këtë dyqanin ai në fakultet deklaroi që, “Unë nuk e marr rrogën, se e kom dyqanin kom për jetë mjaft, nuk du me marr rrogën le t’i jetë fakultetit për ata që kanë nevojë”. Po kur u kry krejt, mas luftës kur u kthy në fakultet nuk ka qenë në regjistër të ardhunave (qeshë). Edhe i thanë, “Qysh tash ty me të shti kur s’je në regjistër”, “Po” tha, “une kom punu, nuk kom marrë rrogën po kom punu”. Valla nja dy-tre mujë ka pasë problem, derisa nuk e regjistruan si profesor i rregullt, qashtu.

Erëmirë Krasniqi: E në luftë? Kur fillunë bombardimet...

Kaqusha Jashari: Në luftë, e për luftë është pak ma ndryshe, se si parti na e kemi përkrah aktivitetin që është bo me Rugovën. Për Rambuje, për marrëveshjen, për nënshkrimin e marrëveshjes. Ka pasë edhe ata që kanë kundërshtu. Sa për partinë, na kemi mendu që osht’ mirë me bo marrëveshjen edhe me nënshkru sepse osht’ folë për shkak bombardimit. Edhe na kemi kërku nënshkrimin por nuk osht’ bo nënshkrimi, po masanej osht’ lonë për 15 ditë me shku në Pariz edhe na kemi delegu prej partisë këtë Ilaz Kurteshin, ai ka qenë anëtar i kryesisë, ish funksionar edhe ai ka qenë atje. Osht’ nënshkru, u gëzum të gjithë edhe kur erdhi ai na informoi tha, “Do të bohet bombardimi”.

Pjesa e Pestë

Kaqusha Jashari: Na informoi ky Ilaz Kurteshi që bombardimi do të bohet me siguri se ata e kanë vizitu edhe NATO-n. Edhe tha, “Tashti duhet me kqyrë çka ma tutje”, e pyta thashë, “Mirë, çka bojmë na kryetarët e partive e këta?” Që the ti postbilloqet, “Na marrin, na kapin, na... çka?”. “E valla për ato kurgjo s’jemi marrë vesh na. Kur erdhëm këtu, thamë, ‘Secili për veti’”. “Qysh?” “Secili për veti”. Une mendova mos po duhet me u organizu, me shku me u bo ni shtab. Ushtrinë e kemi, po luftohet, diçka. “Ja-a” tha, “secili për veti”, “Ou!” Erdha në shpi i thashë shokut, “Kqyr” thashë, “duhet diçka me bo, se na thanë secili me mendu”.

A une babën e kom pasë në Shipri, se babën kur e qitën prej banesës ai ka shku në Fier. Ka shku në Fier edhe atje osht’ vendos. Ka shku në komunë e ka gjetë emrin e vet në shkollë që ka qenë, atje në Shqipni dokumentacionin shumë po e ruajnë. E kanë gjetë që ka jetu atje, që ka kry shkollën fillore në Fier edhe meniherë ja kanë dhonë shtetësinë. Meniherë e ka marrë ai shtetësinë e Shqipërisë, masi ka jetu atje. Edhe na i kemi bo do punë me babën atje, do banesa i kemi marrë në emën tina, se ai si shtetas ka mujt me marrë, masandej i kemi shit, kemi bo do punë të bizniseve edhe e kemi bo ni shpi.

Edhe baba atje, telefon ka pasë edhe na thamë, u morrëm vesh me shokun tha, “Osht’ mirë ti me shku me çikën e smutë, me shku te baba, a une rri këtu” edhe metën vajzat edhe ai, metën këtu. A une shkova te Kika edhe thashë, “A po shkoni ka Shqipëria?” Tha, “Po, vetëm familja po shkon sot masdite”. Po thashë, “A ka vend për mue?” Tha, “Po,” tha, “për ty ka vend”. Edhe une vajzën e smutë, u pregadita me shku, kur kjo Teuta, tha, “Mam, a po ma merr djalin?”

A nipin e kom pasë, s’e di, nja tri vjet qashtu, thashë, “Po, me përgjegjësinë tonde. Ti më ke thonë me marrë, po e marr. Rugës qysh kalojmë, çka bojme nuk e di. Vetëm me hi në autobus e kemi”. S’e di, ke në ora gjashtë, s’e di sa. “Jo” tha, “e bi une deri te autobusi” edhe shkumë. Hinëm une, çika smutë edhe ky. Me autobus në Elez Han, atje na kërkojshin me pagu nifarë depoziti për me kalu kufinin, une kom ditë për ato e u kthym prej kufinit në Elez Han edhe pagujtëm atje s’e di sa marka.

Erëmirë Krasniqi: Përmes Maqedonisë shkutë në Shqipni a?

Kaqusha Jashari: Po, po, në Elez Han u nalëm na aty, u konë nifarë, ke nifarë tollovie. Policët dilshin-hishin, dilshin-hishin, s’e di. Ai kondukteri i autobusit na mur krejt pashaportat, shkoi, nuk e di çka ka ndodhë, kur ka ardhë me pashaporta ka ardhë, jo policë hiç. Tha, “Shuj se i kanë vra nja katër policë në Velani e jonë hallakat krejt”. Në Velani ka qenë nifarë sulmi s’e di, katër policë bash qat masdite. Edhe këta as s’kanë kqyrë, na lshunë, merre me mend ti na lshunë. S’kanë hi mrenda, më kishin njoftë, pashaportën me kontrollu e kishin pa emrin.

“Qysh i kom dhonë, qashtu i kom marrë” tha, “as s’kanë kontrollu, as kurgjo”. Na shkepi ky, “Shuj se shpëtum” tha, “vet” (qeshë). Edhe shkumë qashtu kalum Maqedoninë, shkumë në Tiranë. E masandej prej Tiranës une hina në autobus për Fier, thashë, “Sa ka për Fier?” Tha, “Tri orë”, nuk thojnë sa kilometra, po atje krejt me orë, a din pse? Se rruga e keqe. E tha, “Tri orë”, “Kuku, tri orë a?” “Tri orë”. Tri orë kom udhëtu me këta fëmijë në Fier. Qashtu që, atje kom nejt në kohën e luftës.

Shumë takime kom pasë si kryetare e social-demokratëve, me të hujë, me këta të Shqipërisë. O deshta me i bashku dy parti {mbështet kokën te dora}, dy UÇK-ja, jo dy parti. Kjo e Hashimit edhe kjo tjetra (qeshë), s’u bojshin bashkë. E shko te Sabri Godo, te i Shiprisë, shumë ka qenë i interesum me ndihmu. Shko me to te Pandeli Majko si shefi i qeverisë, shko te ky Paskal Milo ka qenë ministri i jashtëm. T’u luftu me i bashku shumë probleme kanë qenë. Baba i këtij Armend Zemaj, ky që ka qenë ministri i shëndetësisë, baba i tij osht’ vëllau i Tahir Zemaj që e kanë vra.

Takojsha Ramën në zyret e Kosovës atje, “Çka je tu bo Ramë?” “O çka jom tu bo me ditë ti. Ata që jonë me Hashimin me luftu po vijnë” tha, “në Durrës. A ata që jonë me Rugovën duhet me shku me i pritë në Vlorë” (qeshë). “Çka po folë bre?” Tha, “Oh, kaos” tha, “ata po vijnë këtu, a këta anej” tha, “duhet me i bashku”. “Kuku” thashë, “ato nuk e di, ato problemet, po...”

Erëmirë Krasniqi: Qysh e kishit familjen këtu, a mrrijshit me komuniku me ta?

Kaqusha Jashari: Me komuniku me telefon fiks ka funksionu, po kom pasë kujdes çka po foli. Po shumë shpejt këta të mijtë kanë vendos me ardhë në Shipni. Dy vajza edhe Mejdiu, se këtu në rrugë krejt {tregon me gisht majtas} tenka kanë qenë, a kerri jonë ka qenë i bllokum. A këtu ka qenë ky dhondrri, tashti që e kom dhondërr në atë kohë s’ka qenë e martume Teuta hala. Po ai u sillke ka na

edhe ai ka vendos me nejt këtu, po jo me ikë. A Mejdiu me dy çika, kur kanë pa që u liru vendi e mujnë me dalë prej aty me kerr, kanë debloku kerrin, kanë hi edhe kanë shku ka Elez Hani, po rrugës çka s'kanë përjetu.

Kanë përjetu edhe ndaljen jo vetëm prej policëve edhe ushtarëve, po kanë qenë edhe do njerëz që i kanë nalë, që kanë lyp pare, që kanë... Vetëm kanë pasë do pare me veti edhe vetëm shkepshin, shkepshin. Kur kanë ardhë në Maqedoni, atëherë nuk ka qenë problem se Mejdiu ka pasë do studentë që ka dhonë mësim në Tetovë, edhe osht' nalë në Tetovë te ni student, atje kanë bujtë, jane lajmëru që kanë kalu kufinin. Mirë erdhën në Fier. Në Fier kom nejt në kohën e luftës, në Fier kom nejt. Kom qenë...

Erëmirë Krasniqi: A e keni pasë edhe nonën gjallë?

Kaqusha Jashari: Nonën, po, po edhe nonën edhe babën. Ajo ka shku me babën (qeshë). Shumë interesant ka qenë kur ka vendos babi me shku në Shipri, une nonës i thashë, “Kadal me të pytë une diçka. Kërkush s'po të pyt tye, a po don me shku a s'po don me shku? A p'e nin vetin keq në Shipri?” Ajo gjuhën e ka ditë mirë, interesant osht', shumë ka ditë. Tha, “Kqyrë çka po të thom” tha, “me Halilin” me babën, “shkoj edhe në Afrikë edhe për ato mos më pyt” tha, “kurrë”. Edhe përnime kanë kalu shumë mirë në Shipri. Bile do kojshi kanë qenë me prejardhje boshnjake edhe i çojshin fëmitë te kjo me folë gjuhën (qeshë).

Erëmirë Krasniqi: E nana, a e ka ditë shqipen?

Kaqusha Jashari: Po, thashë une edhe këtu ka ditë ajo, me vjehrrën, me kuptu krejt, se me folë pak ka ditë këtu. A atje une jom çuditë kur e kom ni t'u folë shqip me kojshitë uuuu {onomatope} jo çfarë. Ajo vet thojke, “Na kemi shpëtu këtu që kemi ardhë me babën, çka kisha bo” tha, “une në atë vikendicë atje naltë? Më kishin pre sërbët”. Se ajo u tutke prej sërbëve, ajo s'u tutke prej shiptarëve, se ni katun në vazhdim Laishvevc, në vazhdim ka qenë katuni sërb këtu ka Novobërda. “Kuku” tha, “me pasë nejt aty mu më kishin pre” tha, “çfarë, jo, jo”. Ka jetu mirë në Shipri.

Erëmirë Krasniqi: A kanë vdekë atje te dytë?

Kaqusha Jashari: Atje kanë vdekë, rrugës. Na kemi shku me marrë me pru këtu, baba më ka thirrë se e hupi vetëdijen e s'folke. Shku me kerr me marrë edhe vdiq sa kemi hi në Kosovë. Edhe këtu e kemi vorros, në Gilan, afër vëllaut, se ni vlla e kom pasë që ka vdekë në aksident e në Gilan osht' vorros edhe nona afër. E shumë ke problem vorrimi i saj, jo problem, po une kom mendu që del. Kom shku atje me Mejdiun për vend edhe ajo më ka lonë ni amanet moti, nona. Kur kemi shku me vizitu vorrin e vëllaut, tha, “Une kur desë” tha, “dikun sa ma afër djalit”.

A me ni rreth të rrethum janë muslimanët me ortodoksë në Gilan, s'e di a e dini? Janë me ni vend vetëm një përrockë e ndanë. Edhe jo t'u mendu që osht' ortodokse që s'e pranojnë muslimanët. Tha, "Kur desë une sa ma afër djalit, ma afër përrockës, ma afër djalit". E kur kom shku me bisedu për nonën që duhet me vorros, thashë, "Këtu e kom vëllaun" thashë, "sa ma afër se duhet knej", e tha, "Pse knej?" "Po" thashë, "ortodokse osht'". "Po çka ka lidhje?" Po, thashë, "Mos po çohet najkush me thonë, 'Pse e keni vorros grunë ortodokse, çka di une'". Me 2007-tën ka qenë, jo 2006-tën, baba 2007-tën.

Thashë 2006-tën, çka di une në atë kohë. Tha, "Na len neve përgjegjësinë" tha, "në qoftë se ka vend ngat, na e bojmë aty, te vëllau, a jo knej se a p'e sheh që i kanë prishë krejt këtyne sërbeve poshtë". Edhe përnime osht' prishë. E gropunë thanë, "Jo këtu dheu koka çutë, po s'osht' vorr". Edhe bash ngjit me to edhe uh sa jom gëzu. Qat vend përmi ka qenë shprazët thashë, "Ma rezervon këtu për babën" mos me ni baba. Po ai mas ni viti edhe vdiq edhe ai, qashtu që te tretë i kom atje.

Erëmirë Krasniqi: E qysh e vazhdut aktivitetin politik mas luftës, po mendoj a u kyçët ma shumë?

Kaqusha Jashari: Mas luftës, mas luftës na kemi majt rregullisht, partinë e kemi majt mirë. Kemi majt zgjedhjet, kemi majt kuvendet, puna zgjedhore përmes OSBE-së, të regjistrum në KQZ krejt ka funksionu fortë mirë. Po diqysh socio-demokratët te na, nuk osht' idea e pranushme në Kosovë, krejt e lidhin me socializmin, me komunizmin, krejt mendojnë që kjo parti social-demokrate osht' qati orientimit si vazhdimësi. Edhe une bash për shkak kësaj kom thonë atynve në parti, thashë, "Mos u idhnoni, vetëm une po du me kërku, s'po du me dhonë dorëheqje në atë kuptim 'Po shkoj!' Vetëm ta gjejmë kush mundët me vazhdu në parti, se une mendoj se nuk osht' rendi me vazhdu".

"E pse? E qysh?" "Se jom ajo që kom qenë kryetare e Partisë Komuniste me ni kohë edhe une mendoj se edhe këta të huajt e kanë pak ndaj meje nashta një, një rezervë" edhe thashë, "pa idhnim". "Jo-jo, po-po" thashë, "Une ta dini që duhet me gjetë dikend". Edhe dul, nuk osht' rasisht nashta po u befasova, Agim Çeku si kryeministër deklaroi, se pyti dikush, "Çka po do me bo ma tutje?" Tha, "Po du me formu ni parti social-demokrate. S'po du me shku te Aleanca". Se kur ka shku, kush ka qenë aty, a Ramushi që ky e zvendësoi a kush? Qashtu diçka, edhe ai tha, "Jo me Alenacë, po po du me formu Partinë Social-Demokrate".

A nënkryetar te na Zekë Çeku, kusherini i tij. Thashë, "Zekë, pyte ti Agimin çfarë partie po don social-demokrate kur na e kemi. Le të vjen te na". Edhe ka folë me to, tha, "Qysh me ardhë te ju kur osht' Kaqusha aty?" Thashë, "Kaqusha" thashë, "thuj atina që une tërhiqëm. Lirisht le të vjen". Pak kom pasë problem me bindë partinë me e pranu ato si kryetar, nuk kanë qenë të gjithë disponum. Po, thashë, "Hajde Ramushi knej, Hashimi, le të shtyhet edhe ky ushtarak me ta". A Partia Social-Demokrate e ka ni, ni vlerësim, kur vjen ni ushtarak në parti po largojnë.

Ka ndodhë edhe me ni parti në Sërbi, kur ka ardhë ushtaraku, po edhe kur kemi zgjedhë Agim Çekun, ka pasë problem kur u dufke me shku në takimin social-demokrat. Se nuk deshtën me marrë, me thirrë, merre me mend, se ka qenë ushtarak {bën grimasë sikur habitet}. Une jom befasu, vetëm e vërtetë osht'. Shkumë me to, por me ju tregu të vërtetën une jom befasu për të keq me to. Ai nuk ka qenë njeri politikan, në atë kuptim me dëgju njerëz, me pasë durim, po krejt me nifarë nervoze, jo me majt mledhje të gjata me dëgju njerëz po vetëm shkurt. E, "Ju vazhdoni, une kom punë", dilke, nuk ka qenë i rehatshëm. Edhe neve nuk na ka, qysh me thonë, nuk ka qenë në dobi të partisë fare.

Prej tij ka fillu partia teposhtë, masandej u paraqitën këta të Vetëvendosjes, "Po dojmë me formu Partinë Social-Demokrate". Kur kanë shku në KQZ, kanë thonë, "S'mundeni ju me qat emër se ekziston". Edhe mu po më pyt Dardani [Molliqaj], "Çka u bo kjo që s'po mujmë me formu social-demokrat?" "S'munësh se këtë titull, mundesh me program po qite me tjetër titull". "Jo, s'po dojmë tjetër, po dojmë këto". "Po ti, hajdeni" edhe i pranum dymdhetë deputetë edhe u fuqizu partia, a di sa mirë. Me Shpend Ahmetin, me... po u dorëzun more, herën e parë në zgjedhje hupën, ikën. "Po ju a po mendoni qashtu osht' me majt partinë, qaq lehtë? Duhesh me luftu, duhesh me... yhh {onomatope}". U tërhekën e qashtu që metën disa aty. Na jemi hala anëtarë po.

Erëmirë Krasniqi: Veç m'u kthy edhe te ni moment, te Pavarësia edhe po e përmbyllim. Ju thatë që keni qenë nënshkruse, a mundesh me na kallxu q'atë ditë qysh ka qenë për juve?

Kaqusha Jashari: Qysh ka qenë (qeshë), ehh {onomatope} shumë është interesant, mirë që më ke pyt. Kur jom bashkangjite në koalicion me PDK-në, ke ni atmosferë e përkrahjes, nuk është vetëm partia jonë po jonë edhe kjo Partia Unikomb, jo Unikomb, qysh thirrët këtina [Valon] Muratit...

Erëmirë Krasniqi: A Bashkimi Kombëtar.

Kaqusha Jashari: Bashkimi Kombëtar, i kanë bo disa parti e me ta në kolaicion. Edhe mu më kanë thirrë, ky Hajredin Kuçi më thirri tha, "A po vjen në koalicion me PDK-në?" U ula bisedova, kenë shumë korrekt. Thashë, "Po. Në qoftë se fitojmë na deputetë atëhere ato të ardhurat që i takojnë për ni deputetë me i dhonë partisë, ani që jemi në koalicion". "Ja" tha, "aty, aty nuk diskutohet" edhe përnime kanë qenë korrekt. Edhe në listë më murrën mue.

Edita Tahiri më thirri tha, "Kë nënshkru" tha, "pyt allahile a më pranojnë edhe mue". Thashë, "Pysi". Edhe i thashë Hajredinit, "Qe Edita don", "Ani hajt masi po thush ti". S'osht' që kanë pasë bash qef ato me marrë, po Editën e kanë përkrah kudo shumë kjo Ambasada Amerikane. Ajo që ka qenë në atë vendin e koordinatorës edhe për dialog, ajo osht' krejt iniciativa e këtyne amerikanëve. Jo këta, këta tonët që kanë qenë të disponum. Edhe e bonëm, une kom qenë në atë grupin parlamentar. Ka qenë edhe ky, ky... i partisë LPK-së, Xhemajli, i LPK-së, Emrush Xhemajli, Emrush Xhemajli.

Edhe atje në këtë grupin parlamentar e kem pasë edhe vendin afërsisht edhe të caktum ku me, ku me u ulë. Edhe e kanë respektu ato çka jemi marrë vesh po edhe ju kom thonë që, “Diskutimet e mia mos pritni me qenë gjithmonë pro juve. Në qoftë se nuk më pëlqen diçka që ju e keni qëndrim une e maj qëndrimin e partisë teme. A në qoftë se duhet diçka më nënshkru, me dhonë votën une jom me juve, se jom në koalicion. A për diskutim në qoftë se diçka nuk më pëlqen, une nuk ju përkrahi” edhe qashtu edhe kom vepru. Kur erdh dita e Pavarësisë, majtëm, e kemi ditë që atë ditë duhet me nënshkru atë deklaratën.

Edhe çka ke interesant, e caktunë mledhjen e grupit parlamentar, para mledhjes së Kuvendit, krejt gratë që kem aty u veshëm kuq e zi, pa u marrë vesh, hiç. Kur hinëm mrena {shikon si e çuditur}, ama e dukshme. Une kom pasë kostimin e zezë me funin, kostim të ri kom ble, edhe shall kuq e zi {bën sikur vendos shallin}, shall të bukur. Krejt i kom ble këtu në qendër. Kur p’e shoh edhe ajo, Dauti ajo Nerxhivane, ajo profesoresha e juridikut , kuq e zi. Gra të PDK-së, krejt kuq e zi. Mashkuj asnji, mashkujt ato kostimet, kravatën e rëndomtë, hiç kërkush, a gratë krejt. Palidhje bre, edhe s’kemi pasë nevojë bash. Edhe po presmi aty, po vjen Hashimi (qeshë), “Sot” tha, “nënshkruhet, kem me nënshkru. Sot aprovohet edhe flamuri edhe himna”.

Erëmirë Krasniqi: Nuk e dishit ju për këtë pjesë a?

Kaqusha Jashari: Kërkush, na nuk dishëm diçka. “Çfarë flamuri?” Tha, “Qetashti keni me pa. Mu më pëlqej edhe juve duhet me ju pëlqy”. Qashtu ka thonë ky {mbyll njërin sy}, ama si sot... “Mu më ka pëlqy edhe juve duhet me ju pëlqy”. Edhe na dhanë këtë flamur qysh e kemi, qe e kom atje {tregon djathtas me dorë}. “*Hah!*” {onomatope} Emrushi ngat meje deshta me ngucë, se shumë na kanë kritiku në ish Jugosllavi Kosovën, që na flamurin për Kosovën e bonëm kuq e zi nisoj krejt po e qitëm yllin, yllin aty me pasë dallim mes flamurit Shiprisë edhe Kosovës. Se nuk munët ni, ni flamur me qenë për dy shtete edhe duhet me dallu këtë, edhe na yllin a kuq e zi.

E kur na dhanë aty krejt kaltërt, sarit, p’e kqyri une. Thashë, “Ti Xhemaj!” thashë, “Emrush, a je tu pa flamurin?” “Po, bre”. “A p’e sheh?” “Po”. “Ku ka” thashë, “kuq e zi?” “Shuj!” {ngrys fytyrën}, “Jo, jo, shuj”, thashë, “na dulëm tradhtarë që në ato kuq e zi e qitëm atë yllin e kqyr tashti sa ylla jonë këtu, e baza ku osht’? Kaltërt” thashë, “kuku, që kanë me na thonë ma vonë që jemi konë tradhtarë”, une atina. “Shuj, mos fol, shuj, mos fol!” {flet me zë të vogël} (qeshë). “Shuj, mos fol!” A kqyr çka po të thom, une bojsha hajgare me to s’e kom ni prej tij për këtë rast të flamurit, a din. Flamuri nuk munët me qenë ni flamur për dy shtete, ajo osht’ absurd po.

“Himna, qetash e dëgjoni edhe himnën”, Hashimi. E dëgjum kërkun fjalë vetëm muzikë, “A fjalë, a teksti?” Tha, “Niherë kështu, niherë kështu” (qeshë). Vetëm këta të PDK-së a din çka, shumë të dëgjushëm, kur thotë Hashimi diçka kurgjo aty amin. E masi kemë edhe na në koalicion e pralum, une nuk jom prej atynë që kisha kundërshtu diçka. Se qe, në Bosnë, qysh e bonën Bosnjën me qat flamur

gati ka Evropa, se ato ngjyrat jonë të Evropës. Edhe une e mora këtë flamurin tonë sikur është flamuri për të ardhmen, për Evropë, a din edhe qashtu.

E kur erdh rasti me nënshkru e nënshkruva sikur tjerët, po m'u duk që ai lapsi diçka u shterr (qeshë). Qe këtu e kemi {tregon përballë}, na kanë dhonë masandej me qitë në kornizë aty naltë. E kom edhe fotografinë e nënshkrimit. E moment i cili nuk harrohet, po ju tregoj, me pasë zgjedhë momentin kur me qenë une në parlament e kisha zgjedhë këtë moment të nënshkrimit. Po, ka ndodhë rasisht, s'muj me thonë që kom ditë. Na e pritshmi ditën e shpalljes, na e pritshmi prej luftës po nuk, nuk erdh kaq shpejt.

Erëmirë Krasniqi: A keni festu najqysh, çfarë dite ka qenë mandej?

Kaqusha Jashari: More ditë shumë e ftohtë ke, a ju kujtohet? Tepër ftohtë! Na në shpi kemi festu, në shpi e kemi bo tortën. Masandej edhe për niqind vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, e bona ekspozitën se më kërkun atje në këtë bibliotekën. Edhe ke festa nëpër qytet, a ju kujtohet? Kuq e zi, kuq e zi edhe tortën e porositëm këtu, erdh krejt familja. Kom edhe ni album të veçantë për niqin vjetorin. Fotot une i du shumë edhe çdo rast kur osht' interesant e boj fotografinë. Qashtu.

Erëmirë Krasniqi: A keni diçka me shtu? Diçka që na s'kemi ditë me ju pyt.

Kaqusha Jashari: Po nuk kom, nuk kom çka. Gati krejt kom folë për momente që kom pasë jetësore. Nuk kom... Une vetëm këto kisha thonë tashti, po mendoj për veti, une në familjen teme kom qenë e para, masandej vllaznit. Si e para m'u dok që gjithmonë kom pasë ma shumë përgjegjësi edhe ma shumë kanë kërku prej meje prindët. Po tashti kur po mendoj se kom pasë tri vajza, dy i kom, kom ni nip edhe p'e shoh që o shumë me rëndësi që femra me mujt veten me pavarësu. Me qenë e mjaftushme për jetën e vet edhe me i ndihmu tjerëve.

Qashtu që, te na ekziston hala ajo për djemtë si prioritet, mirë osht' me pasë djalë, kur lindë djalë po gëzohen. Në kohën e fundit tashti jonë do konga që po thojnë "Kush ka çikë, ka botë". Une po thom përnime për vajzat, për me pasë ni jetë të sigurtë, ni vetëbesim duhet me, me kry. Une jom ma shumë e interesume vajzat me kry fakultetin se sa për mashkullin. Për mu, për shembull vajza me kry fakultetin, vajza me marrë patent shofer. Une po thom ma shumë kisha pasë qef vajza jeme me pasë shkollën e mesme edhe patent shofer, se fakultetin pa patent, edhe pa gjuhë. Fëmitë e mi krejt kanë shku gjuhën me kry deri në fund. Qe kjo vajza që ke, ajo mesa, e ka kry nivelin ma të lartë, i ka kry të gjitha. Munët me folë anglisht nisoj sikur shqip.

Qashtu që, une mendoj se shumë duhet me pasë kujdes çdo familje që femrat me i përkrah edhe me ju dhonë ma shumë përparësi për me qenë person në veti. Se ndikon pozitivisht edhe në krijimin e familjes të vet po edhe shoqnia ndryshe e pranon. Bile edhe familja e burrit ndryshe po të shiqon se

me qenë e pashkollume. Mendimi jem osht'. Edhe fëmijtë e mi kanë arritë ato, pos asaj që ka qenë smutë prej lindjes edhe që nuk osht' mo, se këto dyjat e kanë arritë deri në fund.

Anita Susuri: Falemnderit shumë për intervistën.